



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave të
Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”
ofruar nga
“Universiteti POLIS”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Florim Grajcevc

2. Dr. Gjergj Thomai

Maj/2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Integruar “Planifikim dhe Menaxhim Urban”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave të Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 698, datë 11.10.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASH Nr. 102, datë 24.04.2009
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.157, datë 10.09.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MAS nr.266, datë 20.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikël i dyte i integruar
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite/ 10 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe te plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	32 PAE/ 10 PAK v.a. 2021-2022 23 PAE/ 14 PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	70
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave Master i Shkencave të Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, Universiteti POLIS, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim.

Me VKM nr. 698, datë 11.10.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, Universiteti Polis" dhe udhëzimit nr.30 datë 26.09.2007 lidhur me hapjen e procedurave për programet e studimeve në ciklin e parë dhe të dytë, shënohen fillimet e punës së IAL.

Me VKM nr. 5882/1 të datës 08.11.2012, miratohet ndryshimi i statusit të Institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë private "Universiteti Polis" nga shkolla e lartë universitare në Universitet.

Me vendimin nr. 102 të datës 24.04.2009 miratohen programet e studimeve me ndryshime për cilin e parë dhe të dytë, nga studime të ciklit të parë në studime të Integruara me kohëzgjatje 5 vite të ciklit të dytë në të cilin vendim përfshihet programi i studimeve Planifikim dhe Menaxhim Urban.

Akreditimi i fundit i programit të studimeve MSc i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban është i arritur me vendimin MASR, nr. 266, datë 20.05.2016, i cili zhvillohet në 10 semestra (5 vite studimi) me 300 ECTS kreditë, në formë të studimit të plotë.

Akreditimi periodik IAL Universiteti "POLIS" me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023) dhe organizohet me njësitë kryesore:

Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn

Departamenti Art dhe Dizajn

Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri

Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn

Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban

Departamenti i Mjedisit

Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë

Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim

Departamenti i Kërkimit Shkencor

Departamenti i Kërkimit të Aplikuar

Qendra e Burimeve dhe Informacionit

Qendra Studimore Ndërdisciplinorë Kërkimore e Inovacionit

Programi përmban 300 kredite ECTS dhe ka një kohëzgjatje normale prej 5 vitesh akademike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave të Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”.

Bazuar në VKM nr. 109 datë 15.02.2017, me vendimin nr. prot 27 të datës 14.01.2022, ASCAL përcakton grupin e ekspertëve për vlerësim në përbërje nga:

- Prof. Ass. Dr. Florim Grajcevci
- Dr. Gjergj Thomai

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Muhamed Prezja.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në datat 21-22 Shkurt 2022, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit POLIS. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Krahas takimeve, u konsultuan evidenca të ndryshme dhe u zhvillua dhe një tur për të parë infrastrukturën.

Në përfundim u kërkuar evidence plotësuese dhe u hartua Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.




SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Mbështetur në vendim për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, master i shkencave i integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” ofruar nga Universiteti POLIS” si dhe *Aneksi Nr.18*, ky program nuk përmban asnjë rekomandim.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në RVB, IAL raporton për masat e marra për përmirësimin e atyre që raporti i vlerësimit të jashtëm të akreditimit të mëparshëm kishte identifikuar si pika të dobëta. Nga verifikimi gjatë vizitës së GVJ në bibliotekë dhe nga takimi me zyrën e projekteve, rezultoi se vërtet numri i mobilitetit të studenteve dhe stafit të këtij programi është shumë i mirë dhe në rritje të vazhdueshme, si dhe biblioteka krahas fondit fizik, ofronte tanimë qasje dhe në platformat e dy librarive dixhitale: EBSCO dhe JSTOR.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar “Planifikim dhe Menaxhim Urban”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

Standardi L1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Mbështetur në Statutin e IAL (RVB; EV.2, neni 2, 3), misioni dhe vizioni i Universitetit POLIS përfshin: <i>Ofrimin ekselence në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesëve shkencorë të afte për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij. Te pajise studentet me cilësi e lidhshpirt profesional në fushat që mbulon në mënyrë që të ushtrojnë influencë për zhvillim pozitiv të vendit dhe rajonit, të kryejnë aktivitete kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura me veprimtaritë akademike në programet e studimeve, aftësi dhe njohuri teorike dhe praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohore. Objektivat e përcaktuara që të formoj specialist të lartë dhe shkencëtarë të ri në fushat e Dizajnit, arkitekturës dhe Inxhinierisë, shkencave të territorit, menaxhimit dhe politikave të zhvillimit.</i></p> <p>Duke pas parasysh historikun e zhvillimit urban të vendit pas ndryshimit të regjimit (dhe problemet që e shoqëruan dhe u akumuluan) por dhe me nevojën në rritje për mirë-administrimin e territorit, në përputhje me prioritetet e BE – Green deal, ndryshimet klimatike dhe dixhitalizimi, por dhe me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit, ky program studimi i integruara MSc PMU ka një vlerë të veçantë për vendin. Programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>I hapur që nga viti 2007, ky program studimi vazhdon të jetë unik në llojin e tij dhe si i tillë kontribuon në pasurimin e ofertës akademike në vend.</p> <p>Për vitet e kaluara ky program tani më ka një konsolidim të mirë të punës akademike nëpërmjet stafit akademik dhe administratës dhe se interesat e zhvillimit të programit të studimit shkojnë në interes të vendit duke pas një produkt i cili konsiderohet i nevojshëm për vendin. IAL dëshmon shumë aktivitete të cilat prezantohen në raportet vjetore të IAL-së. Veprimtaria e IAL lidhur me synimin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare përveç tjerash dëshmohet edhe me marrëveshjet e bashkëpunimeve të arritura nga Universiteti me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


faqe 5

<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p><i>RVB; Aneksi Nr.17</i></p> <p>IAL ofron një diversitet të programeve të studimeve të niveleve themelore BSc si dhe Master Shkencor, Master Profesional, të cilat mbulohen në mënyrë joformale, duke filluar nga Statuti deri te organizimi i realizimit të tyre. Programi i studimit Master i Shkencave i Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, takon Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban të Universitetit POLIS.</p> <p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat shoqëruese, vizitës në terren dhe kontrollit të dokumentacionit rezulton se Programi i studimit Master i Shkencave i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, sipas përcaktimit të këtyre të fundit në Statutin e Universitetit dhe Strategjinë e Zhvillimit.</p> <p>Objektivat dhe veprimtaritë formuese sipas se cilave është organizuar programi i studimit janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me objektivin e krijimit të ekspertëve të planifikimit dhe menaxhimit urban bazuar në një formim ndërdisiplinor: politik bërje, planifikim strategjik dhe menaxhim urban, dizajn urban, strehim, transport, GIS, etj. me qëllim kompletimin e njohurive në këtë fushë.</p> <p><i>RVB: Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.52.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Plani i përgjithshëm Territorial i vendit, planet ndërsektoriale por dhe planet zhvillimore vendore janë parakusht për zhvillimin e territorit duke ndikuar drejtpërsëdrejti sektorët e ndërtimit, prodhimit, atë bujqësor, transportin etj.</p> <p>Në kohën e hapjes së programit të studimit në vitin 2007, çështja e pronësisë së tokës dhe përdorimit të sajë ishin një problem akut për zhvillimin e vendit. Gjatë takimeve të organizuara në IAL, takimi me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit, GVJ u njoftua mbi veprimet e matshme që IAL ka ndërmarrë që programi të jetë relevant për tregun e punës dhe të i përgjigjet ndryshimeve të vazhdueshme dhe kërkesave të dala në kohë reale. IAL kryen vazhdimisht studime dhe analiza nga tregu i punës, (ky i fundit u kërkua si evidence plotësuese dhe u dorëzua nga IAL).</p> <p>Shkenca e Planifikimit, Menaxhimit, Arkitekturës dhe Urbanizmit që lidhen me Inxhinieri janë promotor i zhvillimit të vendit ndërsa konsiderohen kuadro potenciale për tregun e jashtëm dhe sidomos Evropian. Janë shumë veprime të IAL të cilat mund të klasifikohen si nxitëse për të ofruar tregut të punës kuadër të qëndrueshëm.</p> <p><i>RVB: Aneksi Nr.34</i></p>

<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;</p>	<p>Studentët e diplomuar nga programi i studimit MSc PMU posedojnë njohuri dhe aftësi të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë.</p> <p>Sipas RVB, takimeve me studentë dhe me stafin akademik, rezulton se një numër i studentëve të diplomuar nga ky program kanë zgjedhur të vijnë studimet të ciklit të tretë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Universiteti POLIS në bashkëpunim me Universitetin Ferrara të Italisë organizon studime të ciklit të tretë (PhD në Arkitekture dhe Planifikim Urban).</p> <p><i>RVB</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti POLIS ka në fuqi strategjinë e zhvillimit 2021-2026. (http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/Development%20Strategy%202021-2026.pdf), e cila në strategjinë didaktike përcakton si objektiv konsolidimin e programeve ekzistuese të studimeve, duke synuar mbajtjen e tyre të përditësuar me kërkesat nga tregu i punës në vend (nëpërmjet feedback-ut nga të diplomuarit, institucionet partnere, ekspertet, etj) si dhe me atë tregun ndërkombëtar. Gjithashtu tregues të tjerë të performancës janë numri i të regjistruarve dhe punësimi i të diplomuarve nga ky program studimi.</p> <p>Bazuar në këtë dokument dhe statistikën e dorëzuarë për këtë qëllim, gjejmë se programi i studimit është në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.3</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Universiteti POLIS, organizohet dhe zhvillon aktivitete brenda ligjeve të vendit ndërsa për funksionimin e drejtë ligjor ka të ndërtuara aktet juridike të cilat përmbushin veprimtaritë akademike. Statuti i U_POLIS është shtylla Juridike e Institucionit, e miratuar nga Senati Akademik i IAL-së ndërsa ka të miratuara edhe rregulloret funksionale, të cilat mbështesin dhe rregullojnë veprimtaritë akademike institucionale e të mbështetura në Statut. Statuti përshkruan organizimin e studimeve brenda njësisë të veta,</p>

	<p>kriteret për studime në nivelin e ciklit të parë, dytë dhe ciklit të tretë të studimeve.</p> <p>Pjesë e dokumentacionit mbështetës për RVB janë Statuti, Rregulloret e përgjithshme dhe Rregulloret Didaktike të Universitetit POLIS, si dhe rregulloret e posaçme për programet e studimit për Master shkencor i integruara në Planifikim dhe Menaxhim Urban. GVJ vërteton se këto dokumente janë të artikuluara qartë dhe në koherencë me njeri tjetrin duke përfshi të gjithë spektrin e veprimtarisë akademike dhe funksionale duke ju referuar Programit të studimit MSc të integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban i cili zhvillohet dhe organizohet në përputhje të plotë nga objektivat, misionit dhe vizionit Institucional.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.5, Aneksi 6, Aneksi 7.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSc PMU i përket nivelit 7 sipas KSHK (Korniza Shqipëtare e Kualifikimeve), përmban 300 ECTS dhe ka një kohëzgjatje prej 5 vitesh ose 10 semestrave në përputhje me sistemin e Bolonjës, ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Në organizim dhe përmbajtje programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe akteve tjera juridike të miratuara nga IAL për organizimin e programeve të studimit VKM 41, hamendësuar nga VKM 389 / 2019.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.5, Aneksi 6, Aneksi 7.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Përmbajtja e kurrikulës në nivel lëndësh por dhe nga konsultimi më në detaje të syllabuseve për secilën lëndë, vërehet një gërshetim i mirë i njohurive dhe temave me relevancë ndërkombëtare të planifikimit por dhe lëndë me fokus më të madh në kontekstin shqiptar.</p> <p>Strategjia e hartuar e IAL-së dhe strategjia e agjendës së kërkimeve shkencore e cila përmban tri fusha në konceptin e zhvillimit të sajë, duke insistuar në përmirësimin e vazhdueshëm dhe konsolidimin e kurrikulave ekzistuese, diversiteti i ofertës akademike dhe edukimi dual si ndërlidhje e kërkimit dhe mësimdhënies janë bazament për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit MSc PMU.</p> <p>Anëtarësimi dhe pjesëmarrja aktive e POLIS në rrjetin e shkollave europiane të planifikimit – AESOP bën që Universiteti të ketë qasje të drejtpërdrejtë në diskutimet dhe zhvillimet më të reja lidhur me qështjet e edukimit në fushën e Planifikimit.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.2</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi L3
Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

GVJ konsideron se nga të gjitha dokumentet në dispozicion nga IAL si dhe nga vizitat e zhvilluara në takime të ndryshme programi i studimit MSc PMU ka të qartësuar Objektivat e saja edhe përmes dokumenteve, sikur është rregullorja për programin e studimit që përcakton veprimtarinë formuese në thellimin e ekspertëve duke krijuar alternativ të re të studimeve në këto fusha.

Gjatë hartimit të programit mësimor është mbajtur parasysh raporti midis formave të ndryshme të veprimtarive formuese: veprimtari të formimit të përgjithshëm bazë; disiplina karakterizuese që lidhen me fushën, veprimtari formuese integruese; si edhe në përgatitjen e tezës së diplomës dhe praktike profesionale. Pesha e secilës veprimtari është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Programi i studimit MSc PMU është i integruar dhe zhvillohet në pesë vite (10 semestra) duke mbledhë studenti 300ECTS.

Organizimi i programit të studimit dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të integruar të ciklit të dytë të studimeve.

Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe diskutimet me pedagogët dhe studentët rezultoi që studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur disa metoda vlerësimi të cilat përpiqen të përfshijnë të gjithë gamën e njohurive të cilat studenti përvetëson si (ese, detyra, teste, dorëzime të ndërmjetme).

Programi i pajis studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në Planifikim dhe Menaxhim Urban.

RVB, Aneksi Nr. 7

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe

IAL ka dokument mbi të dhënat e punësimit të studentëve nga programi i studimit MSc PMU. Gjithashtu IAL disponon databazë për Alumni të studentëve të diplomuar. Databazat e mbledhura shërbejnë për treguesit e qëndrueshmërisë së këtij programi të studimeve.

Një studim joformal i tregut është realizuar nga IAL (*me të dhëna demografike, numrat e pritshëm të studenteve që do vazhdojnë studimet e larta për vitet në vijim*) i cili ju dorëzua GVJ si dokument plotësues pas kërkesës së tyre. Studimi është i pasur sa i përket kërkesës (aktuale dhe te

<p>nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>pritshme) për këtë program studimi, kurse nga pikëpamja e ofertës ky program i studimit konsiderohet i qëndrueshëm.</p> <p>Sa i përket marrëdhënieve me pjesëmarrës të ndryshëm nga tregu i punës U_POLIS përfiton informata mbi kërkesat reale nga tregu i punës (vendas dhe ndërkombëtar). Në këtë drejtim IAL ka arritur një sërë marrëveshesh lidhur me bashkëpunime të zbatuara (kompani private, akterë publike të ndryshëm (ministri, bashki, AKPT, etj.) si dhe partnere ndërkombëtare) që e mbajnë të përditësuar me zhvillimet dhe kërkesat më të fundit nga tregu i punës. Njëkohësisht POLIS ka ngritur prej shumë vitesh tashme një zyre të posaçme për mbajtjen e të dhënave të punësimit të të diplomuarve (Alumni) dhe organizimin e takimeve frekvente me ta.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.29; Aneksi Nr.32.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e Programit të Studimit të ciklit të dytë, përkatësisht Master i Shkencave të integruara në “Projektim dhe Menaxhim Urban” janë të përcaktuara duke i zhvilluar përmes kurrikulës e cila ka përmbajtje të cilat përmbushin kompetencat e studentit.</p> <p>Aftësimi profesional i studentëve realizohet përmes praktikës profesionale. Në të njëjtën kohë për të rritur aftësitë profesionale të studentëve mësimdhënia shoqërohet me veprimtari formuese integruese, praktike etj. duke i dhënë rëndësi karakterit interaktiv dhe praktik të programit, veçori e cila ndihmon studentin që të bëjë një tranzicion të butë nga teoria në praktikë. Një rëndësi e veçantë i jepet aftësimin të studentëve nga pikëpamja e kërkimit shkencor duke ofruar lëndë mbi metodologjinë kërkimore si dhe duke zhvilluar projekte me natyrë studimore dhe kërkimore gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe që finalizohen me tezën e diplomës.</p> <p>Nga takimet e organizuara në IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc para diplomimit dhe studentët e diplomuar shfaqin rezultatet e nxënies gjatë studimeve si dhe aftësitë e tyre në profesion duke prezantuar dhe zgjedhur edhe probleme të veçanta profesionale nga operativa – praktika.</p> <p>Përqindja shumë e lartë e të diplomuarve ndër vite është treguesi më i mirë për përputhshmërinë e aftësive të ofruara nga programi me ato të kërkuara në tregun e punës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.32.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban është hartuar mbështetur në përvojat më të mira të BE-së për nga elementet që përmbajnë.</p>

<p>studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>I organizuar sipas sistemit të Bologne-s, programi lehtëson transferimin e studimeve si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Mobiliteti i studenteve për periudha semestrale në institucione të huaja partnere ka treguar gjithashtu një përafrim të mirë të kurrikulës me këto programe ndërkombëtare.</p> <p>Nga takimet e organizuara në IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc zotëronin gjuhën Angleze. Kjo konsiderohet si element përmbajtësor i programit të studimit si dhe mundësia e punësimit të këtij kuadri edhe në nivel ndërkombëtar.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.32.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSc PMU është i bazuar në sistemin e Bolonjës. Zhvillimi i kurrikulës, organizimi i peshës së lëndëve sipas ECTS përkatësisht ngarkesave të tyre, shpërndarjes në semestra duke qenë uniform janë tregues se ky program studimi MSc PMU është konform standardeve Europiane të Edukimit, nivelit të edukimit si dhe i klasifikuar në profesionet e rregulluara. IAL ka një përvojë mbi 10 vjeçare të zhvillimit të këtij programi të studimit që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe përsosjen e arritshmërive.</p> <p>Universiteti gjithashtu ka një politikë të mirë të ndërtuar përse i përket bashkëpunimeve ndërkombëtare të cilat gjithashtu shërbejnë për ngritjen e cilësive të studimeve, sidomos në këtë program të studimit. Krahas partneritetit me aktore vendas (sidomos bashki të ndryshme), dhe institucione homologe ndërkombëtare (sidomos me IHS/Erasmus të Roterdamit, me të cilin IAL ka ofruar dhe program master profesional të përbashkët në fushën e planifikimit), POLIS ka prej vitesh anëtarësim të plote në rrjetë si: AESOP – Shoqata Europiane e shkollave të planifikimit, ISOCARP – Shoqata ndërkombëtare e planifikuesve të qyteteve dhe rajoneve, të cilat i bëjnë të mundur kontakte të shpeshta me praktika të mira evropiane në këtë disiplinë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.34, Aneksi 28, Aneksi 19.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve realizohet përmes praktikës nëpër lëndë të ndryshme (sidomos studio e planifikimit dhe dizajnit urban) por dhe në praktikën profesionale. Mësimdhënia shoqërohet me veprimtari formuese integruese, praktike etj. duke i dhënë rëndësi karakterit interaktiv dhe praktik të programit, veçori e cila ndihmon studentin që të bëjë një tranzicion të butë nga teoria në praktikë. Një rëndësi e veçantë i jepet aftësimin të studentëve duke punuar me raste studimore konkrete dhe angazhimin të tyre në projekte sikur; 100 fshatrat, plane zhvillimore vendore, etj.</p>

	<p>IAL mundëson studentëve për krijimin e praktikave profesionale përmes sistemit mirë të organizuar të brendshëm përmes institutit Co-PLAN pastaj njësisive, përkatësisht; qendrës kërkimore në Arkitekturë, qendrës kërkimore në qëndrueshmëri dhe qendrës së burimeve dhe Informacionit.</p> <p>Në takimet e GVJ me studentët vërtetohet se praktikat profesionale të studentëve të realizuara sipas objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.2.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit por dhe stafin mësimdhënës, u kuptua që programi përmban module dhe lëndë të ofruara në gjuhë anglishte (edhe nga staf i huaj i angazhuar në lëndët semestrale) por dhe në formatin workshop të organizuar në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare (Tirana Architecture Week dhe Tirana Design Week), por dhe workshope bilaterale me partnere të huaj.</p> <p>Jo i gjithë programi organizohet në gjuhë të huaj dhe ky mund të jetë shkaku pse nuk ka ardhje të studentëve nga vendet e tjera.</p> <p>Lidhur me ndërkombëtarizimin e IAL, ekzistojnë dëshmi se angazhimi nuk mungon duke realizuar marrëveshje me shumë institucione ndërkombëtare si dhe bashkëpunimi në projekte të ndryshme institucionale.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr. 19</i></p>			
<p>Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>IAL ka sistem të organizuar mirë të ruajtjes së shënimeve. Për lëndët e ofruara në gjuhën Angleze, syllabusi i lëndës, detyrat e studenteve, procesverbalet dhe dokumentacioni shoqëruar hartohen në gjuhën angleze.</p> <p>Faqja elektronike e Universitetit POLIS është kontribuuese e çështjes së azhurnimit dhe ruajtjes së informatave në dy gjuhë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.4
Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën</p>	<p>Universiteti POLIS, me VKM nr. 698, datë 11.10.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, Universiteti Polis" dhe udhëzimit nr.30 datë 26.09.2007 lidhur me hapjen e procedurave për programet e studimeve në ciklin e parë dhe të dytë,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 12

<p>akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë</p>	<p>shënon fillimet e punës së IAL. Me VKM nr. 5882/1 të datës 08.11.2012, miratohet ndryshimi i statusit të Institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë private “Universiteti Polis” nga shkolla e lartë universitare në Universitet.</p> <p>Sa i përket kapaciteteve ofruese të programit, Institucionet ju nënshtrohen një verifikimi të përvitshëm nga ministria e arsimit, që vlerëson si kapacitetet akademike (njerëzore) ashtu dhe ato infrastrukturore.</p> <p>Akreditimi periodik IAL Universiteti “POLIS” me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr. 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023) dhe organizohet me njësitë kryesore:</p> <p>IAL ka brenda saje tri fakultete dhe një qendër.</p> <p>Nga dokumentacioni i më sipërm vërtetohet e Universiteti POLIS ka një organizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm Institucional duke filluar nga themelimi i tij. IAL ka të krijuara organet ekzekutive të sajë si dhe organet kolegjiale përmes së cilave sigurohet një hierarki e marrjes së vendimeve si dhe zbatimin e tyre.</p> <p>Në funksionimin e njësive akademike, Fakulteteve departamenteve ndihmojnë Statuti i Universitetit, si dhe rregulloret e brendshme të cilat sigurojnë një mbarëvajtje Institucionale pa zbrastësira.</p> <p>Departamenti që ofron programin e studimit të integruara MSc PMU ka 13 anëtarë më kohë të plotë nga të cilët 8 janë me tituj dhe grada (<i>Department of Urban Planning and Management Universiteti Polis</i>) që është dyfishi i kriterëve minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>Kurse në lidhje me infrastrukturën, institucioni disponon bibliotekën, laboratorë, lab mjedisi, lab të efqiencies së energjisë dhe plotëson më së miri kërkesat për ta ofruar program me një cilësi të lartë.</p> <p>Kapacitetet fizike të IAL për numrin e studentëve janë brenda standardeve. Asetet e infrastrukturës 11.020,00 m².</p> <p>GVJ vlerëson se IAL ka kapacitete të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit Master Shkencor të Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.24; Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.27; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1; Aneksi Nr. 42.2; Aneksi Nr.42.3; Aneksi Nr.42.4; Aneksi Nr. 42.5.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencorë i Integruara në Planifikim dhe Menaxhim Urban ofrohet nga njësia kryesore Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, kurse nga njësia bazë Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit Urban.</p> <p>Në këtë kuptim ka një përputhje shumë të mirë në mes të fushës së programit të studimit dhe të dy njësive përgjegjëse.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 13

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.									
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit përkon me kodin “0731 <i>Architecture and town planning</i>” sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED dhe përputhet me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit dhe departamentit që e ofron.</p> <p>Fushat specifike të programit të studimit janë me përmbajtje shumë profesionale të aseteve shkencore të cilat i japin karakterin e veçantë studentit, pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Programi i studimit MSc PMU, përbëhet nga kredite (ECTS), të cilat përcaktojnë peshën e lëndëve. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave (dhjetë semestra) dhe është e ekuilibruar që çdo semestër të ketë 30ECTS.</p> <p>Punimi i diplomës së bashku me praktikën profesionale llogariten me peshë ECTS, dhe pas përfundimit të studimeve studenti merr diplomën me titull MSc Arkitekturë dhe Dizajn Urban, me 300 ECTS.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.19</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti POLIS ka të ndërtuar skemën organizative të sajë duke i përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë akademike, zyrave brenda institucionit si dhe pjesës së administratës së Universitetit. RVB e përpiluar përshkruan marrëdhëniet e mira ndërmjet administratës së Universitetit, zyrave brenda sajë si dhe personelit akademik pa përjashtuar dhe Studentët të cilët janë pjesëmarrës aktiv.</p> <p>Pavarësisht se programi i studimit zhvillohet pranë njërisë prej njësisë bazë të Fakultetit – Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit, në të angazhohen dhe njësi të tjera bazë brenda dhe jashtë njësisë kryesore – si p.sh. Departamenti i Mjedisit, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë por dhe njësitë kërkimore – sidomos Njësia Kërkimore e Qëndrueshmërisë.</p>

	<p>Nga takimi me drejtuesit e Universitetit – Fakultetit, Departamentit si dhe me stafin akademik GJV konstaton se IAL me njësitë e sajë zhvillon dhe organizon punë të kontinuale dhe të pa penguar dhe se secila njësi është e qartë për përgjegjësitë respektive.</p> <p>GJV vlerëson qëndrueshmërinë e institucionit përsa i përket shpërndarjes së përgjegjësisë dhe detyrave të secilit të punësuar në IAL.</p> <p><i>RVB; Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në RVB dhe dokumentacionin shoqërues listohen organizmat me të cilat U_POLIS ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Diversiteti i këtyre partnereve (nga sektori publik dhe privat), por dhe institucione homologe të huaja garantojnë arritjen e objektivave të programit të studimit për pajisjen e studenteve me njohuri bashkëkohore në fushën e planifikimit të territorit dhe aftësimin e tyre praktik.</p> <p>Sa me sipër doli qartë dhe në bisedën me studentet e programit.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34; Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>U_POLIS raporton të këtë më shumë se 20 marrëveshje të posaçme për këtë program studimi.</p> <p>Një pjesë e këtyre marrëveshjeve ishte depozituar para vizitës së GJV në institucion, kurse një pjesë tjetër u verifikua gjatë intervistës.</p> <p>Organizimi i praktikave lëndore e profesionale (internships) është element i pranishëm në të gjitha marrëveshjet me institucionet publike dhe kompanitë private.</p> <p><i>Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34; Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>U_POLIS për të gjitha programet e studimeve i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të praktikave profesionale, ndërsa për studentët pjesë e programit të studimeve MSc PMU, zhvillimit të praktikave ju krijohen hapësira institucionale të mjaftueshme brenda IAL-së, në laboratorë si dhe në Institucione publike si dhe kompani private, studio të projektimit. Edhe në takimet e zhvilluara të GJV me studentët u vërtetua se të gjithë studentët ishin të përfshirë në punë praktike, ndërsa kishte studentë të cilit ishin në marrëdhënie pune dhe njëkohësisht studionin.</p> <p>Pasurimi dhe diversifikimi i marrëdhënieve me punëdhënësit të ndryshëm mbetet një objektiv për IAL, rolin kryesor për mbajtjen e këtyre marrëdhënieve e ka koordinatori i programit të studimit dhe drejtuesi i departamentit.</p> <p><i>RVB, Shënimet në vizitë</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencorë me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Falë qasjeve shumë aktive të Institucionit lidhur me arritjen e projekteve ndërkombëtare (kryesisht të financuara nga BE) krijohen mundësi reale të mobiliteteve të studentëve dhe të stafit akademik në institucionet ndërkombëtare. U_POLIS raporton një rritje të vazhdueshme të shkëmbimit dhe numër në rritje të mobiliteteve për stafin dhe studentet.</p> <p><u>ERASMUS+ (KA1 & KA2) Universiteti Polis</u></p> <p>Universiteti ka të rregulluar infrastrukturën ligjore për realizimin e mobilitetit për studentet. Marrëveshjet e IAL gjithashtu konsiderohen kontribuuese për kërkimet shkencore dhe mobilitet.</p> <p><i>Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në kuadër të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të institucionit (i cili depozitohet pranë MAS), por dhe garanton transparencë e IAL me palët e treta, çdo departamenti i kërkohet të hartojë raportin e vet, pjesë e të cilit është edhe vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet partnere.</p> <p>Ndërsa U_POLIS ka të miratuar strategjinë e zhvillimit e cila ka synim ndërkombëtarizimin e Institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.37; Aneksi Nr.38.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Ky aspekt u trajtua gjerësisht në takimin me stafin i cili konfirmoi disa nga instrumentet e përdorura nga institucioni për të mbështetur stafin në ndarjen e rezultateve të kërkimit shkencor dhe publikimin e artikujve, monografive dhe botimeve të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikim në revistat e vete POLIS (MAD, Habitat por sidomos Forum A+P (www.forumap.org)) që është e njohur si reviste kombëtare nga MAS dhe po punon për indeksim ndërkombëtar, cikli i publikimeve të PhD – OMB series, Western Balkans Territorial Review, etj. - Mundësi pjesëmarrje në konferenca të organizuara nga vetë POLIS si TAW, TDW, edicione të caktuara të ENHR, AESOP, etj. si dhe simpoziume të ndryshme kombëtare, të cilat

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 16




	<p>shoqërohen me botimin e librit të abstrakteve dhe proceedings të konferencës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetje me një buxhet të paracaktuar për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe botim artikujsh ne periodike shkencore ndërkombëtare. <p>IAL në strategjinë e sajë ka në prioritet kryesor kërkimet shkencore.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.34; Aneks Nr.43.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Përgjegjësia për vlerësimin e rezultateve të kërkimit qëndron në disa njësi. Siç na u shpjegua gjatë takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC, kjo njësi ka ngritur një sistem pikësimi me më shumë se 30 komponentë për të vlerësuar performancën kërkimore të stafit. Krahas kësaj njësie dhe departamenti mban shenime për secilin staf dhe harton një raport të vlerësimit të kërkimit në nivel departamenti. Së fundi për botimin e rezultateve të kërkimit, një vlerësim i tyre bëhet me <i>blind peer review</i> si dhe nga bordi editorial.</p> <p>GVJ konstaton se edhe më tutje IAL duhet të inkurajojë dhe të mbështesë edhe më shumë personelin akademik në aspektin akademik dhe financiar për aktivitetet e kërkimeve shkencore.</p> <p><i>RVB; Shënim ne vizite.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të institucionit është dhe strategjia e kërkimit e cila përcakton jo vetëm objektivat e synuara për kërkimin shkencor në Universitetin Polis dhe indikatorët e pritshëm por dhe instrumentet për realizimin e tyre. Workshope të posaçme për kërkimin, konferencat, simpoziumet, mobiliteti i kërkuesve dhe botimet janë mënyrat më të përdorura për nxitjen dhe diseminimin e rezultateve të kërkimit. Një pjesë e mirë e stafit janë të pranishëm në portale të rëndësishme ndërkombëtare të kërkimit si <i>research gate, academia</i>, etj.</p> <p>IAL siguron mbështetje për fushën e kërkimeve shkencore te personelit akademik, përmes politikave të saja, duke realizuar marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>U_POLIS ka të ndërtuar platformën elektronike të Universitetit www.universitetipolis.edu.al në të cilën shfaqen aktivitetet e IAL për kërkimet, projektet ndërkombëtare, publikimet e ndryshme në kohë reale. GVJ vlerëson prezantimin e IAL përmes faqes elektronike.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.34</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.</p>	<p>Sa i përket pronësisë intelektuale, nga biseda me stafin u kuptua që ka pasur disa trajnime për këtë qëllim, jo vetëm me staf por dhe me student, si në kuadër të projekteve Europiane ashtu dhe nga Drejtoria e</p>

	<p>Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale– DPPI, me të cilën Universiteti Polis ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL në takim me stafin akademik lidhur me çështjen e lirisë akademike konstatoi se Fakulteti PMMU ka të përmbushur misionin, duke ruajtur integritetin e personelit gjatë vlerësimeve personale. Punën e pavarur të mësimdhënësve IAL e respekton në maksimum duke mos ndërhyrë në procese akademike.</p> <p><i>RVB: Aneksi Nr.2</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Një pjesë e stafit me të cilët GVJ u takua, kishin qenë ose ishin aktualisht pjesë e programit të doktoratës të Universitetit Polis dhe si pjesë e inkurajimit për punën e tyre kërkimore përmenden; mundësinë e kryerjes së një mobiliteti në një institucion ndërkombëtar partner, mundësinë e botimeve në periodiket shkencore të POLIS, përfshirjen në projekte të ndryshme Erasmus, Creative Europe, Horizon, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

<p>Standardi II.1 Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë U_POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të studimit për Master Shkencor të Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p>Programi i studimit MSc “Planifikim dhe Menaxhim Urban” përmban 300 ECTS, dhe studentët me përmbylljen e të gjithë programit mësimor përfitojnë titullin Master i Shkencave i integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban. U vlerësua se kreditet bazuar dhe në (Aneksin Nr. 7</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 18




	<p>Rregullore program PMU) janë pjesë e një programi me një strukturë e cila përmban 55 lëndë dhe 34 module, ku përfshihet dhe internshipi profesional dhe teza e diplomës.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.5, Aneksi Nr. 14.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i përgatitur si i integruar, që nga procesi i hartimit dhe më tej gjatë zbatimit kujdes të veçantë i ka kushtuar veprimtarive formuese dhe ruajtjes së balancës mes dizajnit urban, instrumenteve dhe politikave të planifikimit. Programi respekton tërësisht kriteret e vendosura në rregulloren e programit të studimit, ndërsa nga të dhënat që Universiteti mban sa i përket studentëve të diplomuar një pjesë e konsiderueshme e tyre punojnë në Agjenci kombëtare dhe rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm territorial, këshilltarë në organizata ndërkombëtare, jofitimprurëse dhe studio të ndryshme të projektimit urban.</p> <p><i>RVB Aneksi Nr.14, Aneksi Nr.14.1.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi nëpërmjet një qasjeje të kombinimit mes teorisë dhe njohurive akademike dhe veprimtarive praktike synon të përgatisë të diplomuar që integrohen shpejt në jetën e tyre profesionale. Modele të ndryshme hasen në Universitet, si studimi i rasteve specifike bazuar në probleme reale, por edhe përfshirja e studentëve në tryeza të ndryshme, workshope, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen në Universitet</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14.1.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi është konceptuar dhe zhvillohet duke synuar aftësim gjithëpërfshirës të studentëve. Për të arritur këtë një pjesë e lëndëve zhvillohen në formë studio, workshope apo në bashkëpunim me partnerë jashtë botës akademike. Në ndërkohë, disa prej lëndëve zhvillohen në bashkëpunim me programet e tjera, si arkitekturë apo mjedis, dhe në këtë mënyrë studentët krahas planifikimit plotësohen me dije në aspektin arkitektonik apo edhe të mjedisit të qëndrueshëm. Thënë kjo, studentët e këtij program pas diplomimit kanë më shumë mundësi për të shprehur aftësitë e tyre në sektorë të ndryshëm</p> <p><i>Aneksi Nr.14.1, Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi është konceptuar, zhvillohet dhe përmirësohet në përputhje me kërkesat e tregut, ndërsa ka si model shkollat më të mira të Menaxhimit Urban dhe Planifikimit të vendeve europiane. Si i tillë është në të gjithë elementet përbërës në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore</p> <p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit – kurrikula, lëndët e organizuara, pesha e tyre është e projektuar si model i mirë.</p> <p><i>Aneksi Nr.14.1, Shënime në vizitë</i></p>

Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Siç është shprehur dhe më sipër programi ofrohet me 300 ECTS kredite me një ndarje të balancuar duke ruajtur raportin midis formimit teorik të përgjithshëm, thellimit profesional dhe lëndëve plotësuese. Në qasje e tillë vlerësojmë se u jep mundësi studentëve të përfitojnë njohuri direkte profesionale, por dhe një qasje multidisiplinare me në qendër sfidat e planifikimit.

Përbërja e programit të studimeve MSc PMU sipas grupeve të lëndëve të klasifikuara:

Lëndët bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; Matematikë, Histori Arkitekture dhe qyteti, Metodatat e kërkimit shkencorë, filozofi hapësire, Ekonomiks, Gjeometri dhe dokumentim grafik, topografi, shkenca e tokës, ligj dhe legjislacioni Urban, statistikë dhe CAD. (në shkallë përqindjeje 18%)

Lëndët karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore: analizë territori dhe vendbanimi, sistemet e planifikimit, plan veprimi/strategjik, strehim dhe projekte për komunitetin, Ekonomi Urbane, laborator planifikim rregullator, menaxhimi i mbetjeve-shërbime publike, planifikim rajonal, politika transporti dhe menaxhim trafiku, BE dhe politikatat territoriale, gjeografi urbane, zhvillim rural dhe agrar, planifikim mjedisor, studio dhe teori dizajni urban, qeverisje vendore, studion dhe teori dizajni urban, demografi, histori dhe mendim planifikimi, sipërmarrja dhe biznesi, vlerësim I pasurisë së paluajtshme, financat lokale, urbanistikë teknike, politika mjedisore dhe studio finale e planifikimi (54%)

Lëndët ndërdisiplinore – integruese nëndiciplina, profile dhe grupe lëndë me zgjedhje: dizajn pejzashi, teknologji dhe infrastrukture qyteti, rigjenerim urban dhe projekte me komunitetin, marketim qyteti, vlerësim i ndikimit në mjedis, menaxhim i zonës bregdetare dhe vlerësim strategjik mjedisor. (15%)

Lëndë plotësuese: GIS, Intership profesional, Plan biznesi, menaxhimi I trashëgimisë kulturore, shkrim akademik dhe metoda bazë kërkimore. (8%)

Në fund të studimeve – Teza – projekti final, punimi i diplomës.

Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Pas përfundimit të studimeve, studenti fiton njohuritë për veprimtari profesionale dhe shkencore në:

- Planifikim
- Zbatim
- Verifikim



	- Analiza dhe studime krahasimi, etj. <i>RVB; Aneksi Nr.14.</i>			
Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>Veprimtaritë formuese dhe ndarja e tyre në këtë program është në përputhje me VKM-se nr.41 date 24.01.2018, i ndryshuar.</p> <p>Përgatitja e temës së diplomës zë një ngarkesë prej 15 kreditesh dhe vlerësojmë se është një proces i vazhduar që finalizohet me dorëzimin e punimit të diplomës, i rregulluar me një kalendar të mirë përcaktuar. Krahas rregullores së temës së diplomës, ky proces rregullohet dhe me rregulloren e përgjithshme si dhe rregulloren didaktike. Nga thellimi teorik në funksion të kërkimit, zhvillimi i idesë së temës së diplomës, dëgjuesat, oponenca e deri te mbrojtja e diplomës, i gjithë ky proces realizohet në formën e një studioje të dedikuar për këtë proces.</p> <p>Diploma MSc ka peshën e sajë prej 15 ECTS dhe zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve. IAL lëshon edhe suplementin si shtojcë të diplomës, me përshkrim të detajuar të njohurive të fituara dhe klasifikimit të kompetencave.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.10</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësitë, departamentet dhe njësia e kërkimit përmbushin të gjitha detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Më konkretisht njësia kryesore është Fakulteti që kryesisht bashkërendon mësimdhënien, kërkimin dhe zhvillimin kulturor. Gjithashtu vlerësohet se Fakulteti është ai që ofron programe studimi të niveleve të studimit dhe në përfundim diplomë sipas programit të studimit. Fakulteti është organizuar në njësi bazë dhe ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër kërkimore. Nga ana tjetër është Fakulteti ai që miraton kriteret e pranimit të studentëve, bazuar në propozimet e njësive bazë, por dhe përcaktimeve të ligjit në fuqi dhe akteve të tjera. Fakulteti drejtohet nga Dekani dhe ky i fundit miratohet nga rektori.</p> <p>Ndërkohë është Departamenti njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 21

	<p>mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Sa i përket përbërjes, vihet re se Departamenti ka shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë dhe tre prej tyre janë me grada shkencore. Gjithsesi Departamenti ka dhe staf ndihmës akademik. Si njësi bazë Departamenti përveçse përgjegjës për programin e studimit, propozon kriteret, numrin e studentëve dhe kriteret për pranimin e tyre. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe emërohet nga Rektori.</p> <p>IAL ka të themeluara edhe disa nga organe kolegjiale të cilat sigurojnë funksion të mirë të Institucionit sikur janë këshilli i etikës, këshilli i profesorëve, NJSBC, Zyra e këshillimit për studentët dhe Zyra e karrierës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.7.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti, si njësi bazë bashkërendon që nga mësimdhënia, kërkimi deri tek jeta kulturore dhe sociale. Drejtohet nga Dekani, i cili plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji sa i përket titullit/ gradës. Ndërkohë kompetencat e Dekanit të Fakultetit janë parashikuar dhe në nenin 19 të Statutit të U_POLIS. Fakulteti është i organizuar në tre njësi, ku bëjnë pjesë Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit urban, Departamenti i Mjedisit dhe Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë. Departamenti është njësi bazë mësimore kërkimore në U_POLIS. Në përfundim të çdo viti akademik departamenti rishikon kurrikulën mësimore, vlerëson nevojat për përmirësim, të kurrikulës dhe plotësimin me stafit të kualifikuar akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.24.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të fuar.</p>	<p>Njësia bazë për vitrin akademik 2021-2022 përbehet nga një staf prej 20 personash nga të cilët 13 persona janë staf akademik me kohe të plotë (PAE) dhe 7 staf akademik me kohë të pjesshme PAK).</p> <p>Kualifikimi i personelit akademik të brendshëm (PAE) përfshin 2 Prof Dr, 6 Dr, 2 Dr në proces dhe 3 Msc. Ndërsa për kategorinë PAK kemi 2 Dr, 1 Dr Proces dhe 4 MSc.</p> <p>Struktura akademike, pjesë e njesisë bazë plotëson të gjithë titujt dhe gradat siç përcaktohet me ligj, ku pjesa me e amdhe e stafit ka titujt dhe gradat e duhura.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.24.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore,</p>	<p>Vihet re se stafi akademik dhe drejtuesit e Departamentit angazhohen/ angazhojnë dhe studentët në punën kërkimore, botime, konferenca etj. Një vend të veçantë zë dhe puna në laborator, për çka është një staf i dedikuar, drejtuar nga përgjegjësi i laboratorit dhe stafi ndihmës, që nga pritësi i mostrave deri tek laborantët dhe ndihmës laborantët. Universiteti Polis ka</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 22




<p>laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>ngritur 7 laboratorë, nga të cilat Laboratori i CAD, Laboratori GIS, Laboratori i Mjedisit dhe Observatori i pellgut të Mesdheut, menaxhohen nga Fakulteti i PMMU-se. Programi i Planifikimit gjithashtu merr asistencë nga "Innovation Factory" strukturë ndërdisiplinore në Universitet, por ka dhe marrëveshje të ngushtë më një sërë laboratorësh jashtë Universitetit. Vihet re se me zgjerimin e hapësirave laboratorike është rritur edhe punësimi i stafit akademik ndihmës.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në takimet me studentët konstatoam se praktika mësimore udhëhiqet nga personeli akademik i departamentit. Gjithashtu edhe ushtrimet laboratorike në ambientet e Universitetit udhëhiqen nga stafi akademik ndihmës.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatorët janë pjesë e rëndësishme për një program studimi dhe si të tillë në Universitetin POLIS janë staf akademik punësuar me kohë të plotë. Vlen të theksohet se koordinatorët janë me eksperiencë dhe njohin mirë programin, nevojat dhe objektivat e tij. Koordinatorët realizojnë takime periodike me stafin dhe drejtuesin e departamentit. Këto takime në Departamentin e Planifikimit janë takime mujore dhe koordinatori pas çdo takimi ndan dhe minutat e takimit në formën e një relacioni të cilat gjenden te arkivuara dhe pranë Fakultetit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit jep llogari Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit lidhur me shqetësimet e studentëve për realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr. 36.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori ndan në mënyrë periodike me drejtuesin e njësisë çdo informacion që lidhet me programin e studimit dhe ndërkohë vihet re se dokumenton në mënyrë të rregullt këto ndryshime.</p> <p>Këto takime organizohen edhe në bazë mujore në nivel të Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban.</p> <p><i>RVB.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban, është i organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, dhe 300 ECTS ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra. Si praktikë vihet re se plani mësimor është përcaktuar në formë vjetore, ndërsa kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga personeli akademik dhe në përputhje me procedurat përkatëse ndryshimet kalojnë procesin e miratimit nga Senati Akademik. Programi mësimor përcakton lëndën, modulën, profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve.</p> <p>GVJ konstaton se materialet e ofruara, takimet me studentët dhe pedagogët dëshmojnë për angazhim maksimal të Departamentit për zhvillimin e programit të studimit duke i përcjellë me përkushtim suksesin e studentëve, duke organizuar kurse shtesë për studentët me qëllim avancimin e kompetencave të tyre.</p> <p>Për funksionimin e programit të studimit departamenti bazohet në respektimin e akteve ligjore dhe rregulloreve të Universitetit.</p> <p>Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Një vështrim i plotë i programeve të studimit, lëndët dhe përbërësit e tij ndodhen të publikuara në faqen e Universitetit duke lejuar studentët edhe para regjistrimit të marrin këtë info. Në vazhdimësi të gjithë studentet pajisen me syllabusin e lëndëve të cilat përshijnë, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Ndërkohë nga muaji mars i 2020 duke konsideruar platformat online për mësimdhënie, U_Polis tashmë ka paketën universitare për këtë platformë ku secila lëndë ka një llogari personale ku hedh të gjithë informacionet e lëndës duke përfshi dhe syllabusin.</p> <p>Ky program studimi i ciklit të dytë është program i Integruar në pesë vite studimi (10 semestra) i cili jep formim më të gjerë në fushën e Arkitekturës dhe Dizajnit. Programi është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr. 7; Aneksi 14.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite</p>	<p>Master i Shkencave i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban, është i organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, dhe 300 ECTS ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 24

<p>sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit në MSc PMU, me nga 60 ECTS për çdo vit akademik, plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore, e cila parashikon studime me kohë të plotë, dhe një minimum prej 300 kredite ECTS.</p> <p>Është përcaktuar qartë se 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor, respektivisht 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor, ndërkohë 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit dhe 1 orë mësimore = 60'</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr. 7; Aneksi 14.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Kurrikula përbëhet nga të gjitha kategoritë e lëndëve të përgjithshme, profesionale, Integruese, plotësuese dhe përmbyllëse. Çdo lëndë ndahet në aktivitete formuese si: Leksione/ Seminare/ushtrime /laboratorë/ detyra kursi/praktika mësimore Studio projektimi - planifikimi.</p> <p>Konkretisht për vlerësimin e arritjeve të studentëve, sipas syllabuseve të dorëzuara nga IAL rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % Frekuentimi - 10% Aktivizimi - 10 % Blloku i Punës - 10 % ushtrimi 1 - 15% ushtrimi 2 - 20 % ushtrimi 3 - 15 % Paraqitja - 5% cilësia e prezantimit Final - 5 % Ese/Detyra <p>Plani mësimor është përcaktuar në forme vjetore. Programi mësimor përcakton lëndën, modulin, profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve.</p> <p>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë (RVB). Mënyra e përcaktimit të krediteve përputhet me dispozitat ligjore në fuqi dhe më konkretisht: Leksionet 8-12 orë në auditor dhe 13-17 orë punë e pavarur e studentit; Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit; Laboratorët/Studio 12-18 orë në auditor dhe 7-13 orë punë e pavarur e studentit. Praktikantët e lëndës janë përfshirë në orët Laboratorë / Studio për shkak të specifikave të programit të studimit. Praktika 75 orë punë e pavarur e studentit, ndërsa Teza dhe projekt Diploma 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit.</p> <p>Syllabuset përcaktojnë shpërndarjen e aktiviteteve mësimore, frekuentimin mënyrën e vlerësimit të studentit për lëndë, vlerësimet gjatë vijueshmërisë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14.1; Aneksi Nr.19.</i></p>




<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ hasi në raste të transferime të studentëve nga institucionet tjera në U_POLIS. Procesi i ekuivalentimit ishte realizuar nga vet IAL duke u mbështetur në programin e studimit të akredituar.</p> <p>Programi ka të përcaktuar qartë dhe në mënyrë transparente kriteret që lidhen me pranimin e studentëve për herë të parë, por edhe studentëve të cilët duhet të transferojnë studimet në Universitetin POLIS. Informacioni dhe procedura për transferimin e studimeve janë të parashikuara në nenin 11 të Rregullores së Programit të studimit. Ky informacion është lehtësisht i qas syllabusinshëm për studentet duke paraqitur një kërkesë në sekretarinë mësimore. Nga aty student pajiset me një listë dokumentacioni që i duhet të dozojë për të ndjekur procesin.</p> <p>Programi i studimit është lehtësisht i mundur të krahasohet me programe nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare për fushat e inxhinierisë së ndërtimit. Këtë e mundësojnë lëndët brenda kurrikulës, pesha e tyre si dhe përmbajtja.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14; Aneksi Nr.14.1, Aneksi Nr.2.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në vazhdimësi të gjithë studentet pajisen me syllabusin e lëndëve të cilat përshijnë, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar.</p> <p>Gjithashtu pranë departamenteve ofrohet informacioni për programet modulet dhe syllabuset, në formën fizike dhe elektronike, përmbajtja e syllabusit është e rregulluar në bazë të VKM 41, date 24.01.2018 i ndryshuar për formën dhe strukturën e syllabusit. Kjo formë reflektohet edhe në platformën e vlerësimit të sistemit të brendshëm “Pitagora”.</p> <p>Forma standarde e syllabusit për lëndët e programit të studimit në MSc PMU është përmbajtjesorë dhe ka brenda vetes planin e punës përgjatë gjithë së zhvillimit, mësimi javor – përshkrimi, sasia e orëve në auditor, në ushtrime, laboratorë frekuenca etj.</p> <p>Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit, syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrave përkatëse. Nga vizita në institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatohet se janë në përputhje me standardet.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.19.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimeve është subjekt vjetor përmirësimi, shqyrtimi dhe rivlerësimi nga njësia. Ky proces i paraprin fillimit të vitit akademik dhe konsideron performancën e stafit nga vlerësimi i cili përbëhet nga katër komponentë. Më pas vihet re se miratimi bëhet nga senati akademik dhe arkivimi i materialit nga përgjegjësit e departamentit, dekani një kopje në rektoratin dhe në sekretarinë mësimore, këto materiale arkivohen dhe mund të gjenden edhe në formën elektronike në arkivin e U_Polis.</p>

	<i>RVB, Aneksi Nr.52.1</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës së mësimdhënies është në norma akademike dhe i shpërndarë përafërsisht në mënyrë të njëtrajtshme.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master shkencor i integruar përkon me Nivelin e dytë në Ligjin 80/2015 neni 75. Vihet re se ngarkesa e programit është objekt shqyrtimi vjetor në përputhje me strukturimin e programit dhe stafin pjesëmarrës. Pedagogët që janë pjesëmarrës në këtë program studimi realizojnë një ngarkesë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimin Nr.29 datë 10.09.2018, i ndryshuar të MASR.</p> <p>Ngarkesa e studentëve në semestra është e ekuilibruar. Gjykuar sipas takimeve me studentët, ngarkesa mësimore në bazë javore për studentët është rreth 25 orë. GVJ konstaton se stafi akademik efektiv i IAL-së është i angazhuar në kohë pune të plotë dhe përveç mësimdhënies ata janë të angazhuar në shërbimet organizative, administrative të Universitetit.</p> <p>Ndërkohë përmbajtja e programit të studimeve, objektivat, vizioni dhe standardet e përcaktuara për këtë program janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mund të vlerësohet se emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga korniza Shqiptare e kualifikimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.25</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit në lëndë/module dhe shpërndarja në semestra me orët dhe kreditet mësimore të ofruara nga ky program vlerësohet se janë në përputhje të plotë me kërkesat e një programi të integruar të ciklit të dytë të studimeve dhe bazës ligjore për arsimin e lartë. Programi me organizimin e tij përpiqet të thellojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Për sa më sipër është</p>




	<p>përcaktuar qartë dhe në nenin 1 dhe nenin 2 të Rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.14</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Struktura e përgjithshme institucionale, ngarkesa, lëndët dhe raporti i teorisë me praktikën janë subjekt i ndërtuar në përputhje me bazën ligjore dhe kriteret e vendosura në Rregulloren e programit, kryesisht në nenin 5. Vihet re se për ngritjen dhe vazhdimësinë e programit janë konsultuar, universitete partnere dhe eksperiencat e shkollave Europiane duke mbajtur praktikat më të mira për këtë program, në tentativë për të qenë koherentë me programet e studimit.</p> <p>Programi i studimit sipas viteve organizohet sipas:</p> <p><u>Në vitin e parë:</u> Analizë territori dhe Vendbanimi I, Histori Arkitekture dhe qyteti I, Histori mendimi i planifikimit 1, Matematike, Shkrim akademik dhe metoda baze kërkimore, Topografi, Analizë territori dhe vendbanimi II, Histori Arkitekture dhe qyteti II, Histori Arkitekture dhe qyteti II, Histori mendimi i planifikimit 2, Shkenca e tokës, Gjeometri dhe Dokumentim grafik, Dita e tokës workshop.</p> <p><u>Në vitin e dytë:</u> Teknologji dhe infrastrukturë qyteti 1, GIS, Sistemet e planifikimit, Ekonomiks, Qeverisje Vendore, CAD, Emergent Urbanism, Teknologji dhe infrastrukturë qyteti 2, Ligji dhe legjislacioni urban, Ekonomi Urbane, Statistikë, Gjeografi Urbane, BE dhe politikat territoriale.</p> <p><u>Në vitin e tretë:</u> Studio Planifikimi Urban, Politika transporti dhe menaxhim trafiku, Demografi, Vlerësimi i pasurisë së paluajtshme, Menaxhimi i trashëgimisë kulturore, Dizajn Peizazhi, Rethinking Cities with Games, Studio dhe Teori dizajni urban, Planveprimi strategjik, Urbanistikë teknike, Planifikimi mjedisor, Strehim dhe Projekte me Komunitetin, GIS 2,</p> <p><u>Në vitin e katërt:</u> Lab. Planifikimi rregullator 1, Financa lokale, Plan Biznesi, Politika mjedisore, Shërbime publike, Resilient Cities, Lab. Planifikimi rregullator 2, Zhvillim rural dhe agrar, Menaxhimi i zonës bregdetare, Rigjenerim Urban dhe projekte me komunitetin dhe Vlerësimi strategjik mjedisor.</p> <p><u>Në vitin e pestë:</u> Planifikim rajonal 1, Metoda të kërkimit shkencore, Studio finale planifikimi, Vlerësimi i ndikimit në mjedis, Resilient Cities, Planifikim Rajonal 2, Teza dhe projekt diploma, Intership profesional, Marketim qyteti dhe sipërmarrje dhe biznes.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori</p>	<p>Sipas Rregullores së Përgjithshme (pika 1) Programi i Integruar i Studimeve Master i Shkencave në Planifikim dhe Menaxhim Urban, është hartuar në</p>

<p>praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, ndërsa në vazhdimësi janë marrë si referencë programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Ndërsa brenda lëndëve organizohen edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional gjë që e rritë efektin e praktikës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përcakton qartë raportet mbi bazën teorike dhe praktike të formimit të studentit, hartohet dhe rishikohet duke konsideruar edhe zhvillimet më të fundit shkencore në fushën e planifikimit, kërkesat e tregun e punës, rekomandime nga sektori i biznesit si dhe rekomandime nga të diplomuarit/Alumni. Ky program synon të përgatisë profesionistë për tregun kombëtar të punës, ndërsa nëpërmjet shkëmbimeve që ju ofrohen studentëve, ata që para diplomimit përqaasen me programe të shkollave më të mira europiane.</p> <p>GVJ konsideron se ky program i studimit është i projektuar sipas mundësisë së ofertës të të diplomuarave në tregun e punës. Pjesa praktike në kurrikulë është me hapësirë të mjaftueshme.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi vjetor i syllabusit është detyrë e pedagogut të lëndës, duke konsideruar përditësimet e vazhdueshme në literaturë që kjo disiplinë kërkon. Syllabuset e dorëzuara në departament duhet të përputhen me strukturën e përcaktuar nga rregulloja studimore.</p> <p>Në takimet e GVJ në IAL ndryshimet në syllabuese nga akreditimi i fundit janë të vogla dhe të pa përfillshme.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.52.1</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtjet e programit të studimit sigurojnë mjaftueshëm përftimin e aftësive profesionale dhe shkencore.</p> <p>Kombinimi i mirë i teorisë dhe praktikës, tendenca për të përmirësuar programin duke ju referuar shkollave më të mira evropiane të planifikimit, por edhe nevojave apo kërkesave të tregut, vlerësohet si një garanci që studentët e këtij program kanë përftuar kompetenca dhe njohuri në përputhje me atë që masteri i integruar synon të ofrojë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.14; Aneksi Nr.18.</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Departamenti/Qendra në analizat që lidhen me përmbajtjen e programit vihet re se kryejnë përditësime periodike duke u konsultuar me institucione të rëndësishme në treg që janë ofruesit më të rëndësishëm të vendeve të punës që lidhen me programin. Pjesë e kësaj janë edhe përvojat e studentëve që kanë ndjekur/ndjekin studimet në këtë program të cilët janë të punësuar në tregun e punës.</p>

	<p>Në takimet me studentët GVJ vlerëson njohuritë e fituara të të diplomuarve si dhe ofertën e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>RVB; Takimet e GVJ ne IAL; Aneksi Nr.14;</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Siç është theksuar dhe më sipër, bashkëpunimi faktik me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të sektorit publik apo privat, konsultimet e shpeshta me ta çojnë në përmirësimin e programit, në aspektin cilësor në hap me zhvillimet kërkimore dhe akademike, por dhe me nevojat e tregut.</p> <p>Nga takimet e organizuara te GVJ me koordinatore të programit, ndryshimet e përmbajtjes së kurrikules behen ne varësi te tregut te punës dhe feedback-u merret nga tregu përmes bashkëpunimeve qe ka IAL përmes marrëveshjeve te realizuara.</p> <p><i>RVB; Takimet ne IAL; Aneksi Nr.52.1; Aneksi Nr.36; Aneksi Nr.32.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi i ciklit të tretë, i cili ofrohet në Universitetin POLIS në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës në Itali, është një bazë e mirë për njohuri të avancuar dhe thellimin kërkimor të stafit të ri. Vlen të përmendet se rreth 36 doktorë të ri janë diplomuar nga 2016-2020, dhe 22 prej tyre janë angazhuar si staf me kohë të plotë.</p> <p>Programi i studimit ka përmbajtje që siguron njohuri të mjaftueshme të formimit teorik dhe shkencor për studentin.</p> <p>Niveli i lëndëve teorike në përmbajtje të kurrikulës siguron që një student mund të merret me aktivitetet shkencore dhe të vazhdojë studimet në ciklin e tretë.</p> <p><i>Aneksi Nr.19; Aneksi Nr.14.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet përfundimisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Angazhimi i Personelit Akademik në arritjen e Objektivave nga Kurrikula bëhet përmes lëndëve dhe moduleve si dhe syllabuseve të tyre. Në secilin syllabus janë të specifikuara objektivat e lëndës që shkojnë paralel me objektivat e përgjithshme.</p>

	<p>Personeli akademik qoftë ai me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme i angazhuar në Universitetin POLIS është në përputhje me kriteret e përcaktuara për këtë program studimi. Universiteti, ka jo vetëm numër optimal të stafit akademik të angazhuar, por edhe të pajisur me titujt dhe gradat e nevojshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.19; Aneksi Nr.14.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Siç e përmendem dhe në paragrafin e mësipërm, vihet re se stafi akademik me kohë të plotë apo të pjesshme disponon titujt dhe gradat e nevojshme por edhe ekspertizën e nevojshme, për të ofruar mësimdhënie cilësore në këtë program.</p> <p>Per vitin akademik 2020-2021 kemi 23 PAE me 2 Prof Dr, 1 Prof As, 1 Prof, 10 Dr, 7 Dr Proces dhe 2 Msc. Ndërsa PAK janë 1 Prof Dr, 2 Prof As, 6 Dr, 2 Dr Proces dhe 3 Msc.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 kemi 32 PAE me 2 Prof Dr, 12 Dr, 8 Dr Proces dhe 10 Msc. Ndërsa PAK janë 1 Prof As, 5 Dr, 1 Dr Proces dhe 3 Msc.</p> <p>Objektivi kryesorë i programit të studimit duke qenë që është të përgatisë Studentin profesionalisht në fushat për Planifikimi dhe Menaxhimin Urban realizohen përmes lëndëve dhe moduleve teorike, ushtrimeve numerike, Laboratorëve, punës praktike, vizitave në terrene si dhe një mori aktivitete tjera që çojnë drejt arritjes së këtij qëllimi të përgjithshëm. Këto objektiva të hartuara nga IAL realizohen nëpërmjet shërbimeve Administrative si dhe personelit Akademik të angazhuar.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit. Stafi akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program.</p> <p>Stafi Administrativ, dhe Menaxherial i Fakultetit, përkatësisht Universitetit angazhohen në maksimum që Studentëve të ju ofrohen shërbime cilësore, në kuptimin e shpejtësisë, saktësisë dhe sigurisë. Të gjitha këto shërbime janë paketë shërbimi që prodhojnë cilësi duke numëruar infrastrukturën e Fakultetit, shërbimet e informacioneve, kontratat, Bibliotekën etj..</p> <p>IAL nxitë bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes anëtarëve të njësisve që u vërtetua edhe nga takimet e GVJ me pedagogët.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.25, Aneksi Nr.23</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me</p>	<p>Vihet re se krahas mësimdhënies, stafi akademik në mënyrë të vazhdueshme është i përfshirë në aktivitete kërkimore, ndërsa një pjesë e stafit të ri apo ish- student po kryejnë dhe studimet në ciklin e tretë të doktoraturës. Krahas punës kërkimore një kujdes të veçantë Universiteti i</p>




programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	kushton trajnimit të stafit në mënyrë të vazhdueshme. Stafi në pjesën më të madhe të rasteve propozon ose merr pjesë në projekte të cilat janë në qendër të interesit të tyre të kërkimit ose janë fusha ndërlidhëse. <i>RVB, Aneksi Nr.25; Aneksi Nr.23</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Universiteti nxit bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes anëtarëve të stafit si në nivel institucional dhe në nivel ndërinstitucional. Vihet re se Universiteti në përgjithësi është i angazhuar në projekte të cilat implementohen në bashkëpunim me Universitete të tjera, nga vendi rajoni dhe Evropa. Një angazhim i tillë, mundëson që stafi gjatë gjithë kohës të ketë mundësi të shkëmbejë eksperiencë, që veç ngritjes profesionale transferon te studentët praktikantët më të mira. IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore për realizimin e praktikës profesionale. <i>RVB; Aneksi Nr.32</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve të cilat shfrytëzohen nga studentët udhëhiqen nga stafi ndihmës i universitetit i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve ndërsa mësimdhënësi ishte staf ndërkombëtar. Siç e theksuam dhe më sipër rritja e laboratorëve në Universitetin POLIS, veç mundësive që i jep stafit kërkues dhe studentëve për të zbatuar në praktikë dijet, ka rritur numrin e të punësuarve me detyre personeli ndihmës shkencor me rreth 50%. <i>RVB</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e	Universiteti realizon studime të vazhdueshme të tregut të punës, rezultatet e të cilave synohet të ndikojnë në përmirësime apo ndryshime të programit mësimor dhe përputhshmëria e tij me tregun e punës. Vihet re një bashkëpunim në rritje me Agjenci lokale dhe kombëtare, por jo rrallë dhe ndërkombëtare. Krahas bashkëpunimit në aktivitete të ndryshme, shpesh

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 32

<p>bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>rezultat i këtij bashkëpunimi janë dhe ndërhyrjet në programin mësimor, pas një sërë konsultimesh mes aktorëve. Është menaxhmenti i U_POLIS i cili ne bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve, shefat e departamenteve, Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës si dhe koordinatore të programeve konsultohen për ndryshimet eventuale dhe përditësimin e kurikulës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.34; Takimet ne IAL.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>IAL nga marrëveshjet institucionale të arritura, të njëjtat i shfrytëzon më së miri për nevojat e saj institucionale dhe sidomos për mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale.</p> <p>IAL ka të krijuar Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) e cila është një njësi e që asiston dhe ndjek studentet, si gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në treg, arrijtjet e tyre, lobimin për mbrojtjen e te drejtave të profesionit, ruajtjen e lidhjes me U_POLIS përmes Shoqatës ALUMNI, inkurajimin e frymës së bashkëpunimit si komunitet, mbështetjes dhe filantropisë. Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni përmbledh informacion për studime, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup.</p> <p>Zyra e Këshillimit të karrierës është ngritur në U_POLIS që në vitin 2009, e quajtur asokohe Zyra e Karrierës. Sot Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) në Universitetin “Polis” vlerësohet si njësi strukturore dhe e pavarur nga pikëpamja operative. Jo rrallë një pjesë e ndryshimeve apo dhe propozimeve për ndryshim në programin mësimor vijnë pikërisht nga kjo zyrë. Nga takimet e GVJ me ZMSKK është konstatuar se kjo zyre jep kontribut lidhur me ndryshimin e kurrikules në bashkëpunim me Alumni duke provuar feedbackun nga studentet e diplomuar,</p> <p><i>RVB; Takimi me studentet ne IAL; Aneksi Nr.52.1; Aneksi Nr.29; Aneksi Nr.30.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e mësipërme mban një kontakt të vazhdueshëm jo vetëm me studentët aktualë, por edhe me të diplomuarit vit pas viti. Tashmë ndër vite vihet re rritje e komunitetit të të diplomuarve dhe mbajtja e kontakteve me ta mund të vlerësohet si një mundësi e mirë për të qenë më afër nevojave të tregut të punës. Pikërisht nisur nga ky fakt, mund të vlerësojmë se sugjerimet e komunitetit të të diplomuarve janë të rëndësishme për përmirësimin e programit të studimit.</p>

	<p>GVJ në takimet me zyrtaret e Universitetit konstaton se Alumni posedon shënime statistikore të cilat ruhen nga IAL lidhur me plasmanin e studentëve të diplomuar ne tregun e punës. Këto kontakte ruhen nga Universiteti duke i ftuar shpeshëhere ish student për raste të ndryshme.</p> <p><i>RVB; Takimi me studentet ne IAL; Aneksi Nr. 30; Aneksi Nr.51.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>Kërkimi në Universitetin POLIS vlerësohet si një aspekt mjaft i rëndësishëm. Krahas rritjes akademike, punës në vazhdimësi me partner vendas dhe të huaj, prioritetet kombëtare, rajonale apo kombëtare, duket se janë një mundësi e mirë për përmirësimin apo riorganizimin e një programi të studimit në Universitetin POLIS.</p> <p>Nuk mungon bashkëpunimi i U_POLIS me institucione kërkimore dhe shkencore. IAL ofron listën e bashkëpunimeve Institucionale vendore dhe ndërkombëtare të cilat edhe konsiderohen ndihmëse për programin e studimeve MSc PMU.</p> <p>IAL organizon edhe trajnime shtese për stafin e vet si dhe për studentët.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.29; Aneksi Nr.32.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>Vihet re se Universiteti në përgjithësi dhe programi në veçanti një vëmendje të i kushton zgjerimit të rrjetit të partneriteteve jo vetëm me institucione ndërkombëtare e lokale të sektorit të arsimit, por dhe me aktorë të ndryshëm nga komuniteti i biznesit, organizmat qeveritare dhe joqeveritare, shoqata dhe organizata profesionale, etj. Shumë nga këto partneritete kanë sjellë ndërkombëtarizim të Universitetit në Europë dhe përcjellin rëndësinë, cilësinë dhe seriozitetin me të cilin ky program operon.</p> <p>U_POLIS së bashku me Universitetin Ferrara të Italisë organizon programin e studimeve të ciklit të tretë – programi i doktoratës të fushave të Arkitekturës dhe Planifikimit që është praktikë e mirë e Institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.34; Takimet e GVJ me IAL.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban është në përputhje të plotë me Strategjinë e Institucionit dhe prioritetet e programit mësimor janë hartuar në përputhje me inovacionin në kërkim, ekselencën akademike dhe nevojat e tregut të punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 34

<p>objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MSc PMU përkatësisht kurrikula me lëndët e sajë dhe syllabuset e tyre qartësojnë prioritetet dhe objektivat e studimit. Ato janë me përmbajtje të thelluar shkencore, që si produkt i programit të studimit do të krijohen profesionist të cilëve ju jepet mundësia për vazhdim të studimeve të mëtejme në ciklin e tretë si dhe mundësi e zhvillimit të veprimtarive profesionale në tregun e punës.</p> <p>Objektivat e programit të studimit përputhen me objektivat e institucionit.</p> <p>Objektivat e Programit të studimit MSc PMU janë të përcaktuara duke u mbështetur në objektivat e përgjithshme të Institucionit dhe deklarojnë: Të përgatisë specialistë të lartë, lider në fushën e planifikimit, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.19; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.14.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Liria akademike dhe objektivi i Universitetit apo njësisë për prioritetet kërkimore duket se janë në përputhje të plotë. Nga ana tjetër liria akademike është pjesë thelbësore e Statutit të U_POLIS dhe Rregulloren e Përgjithshme, ndërkohë që Fakulteti bashkërendon më së miri mësimdhënien, kërkimin shkencor por dhe aspektin kulturor dhe social</p> <p>Departamenti kujdeset për stafin akademik, për ngarkesën e tyre në mësimdhënie si dhe në punët administrative të IAL. Shkalla e lirisë akademike të stafit të U_POLIS është e pa cenuar, ata mund të zhvillojnë kërkime shkencore në mënyrë të pa penguar dhe mund të kërkojnë edhe ndihmën institucionale që në fakt edhe ju ofrohet.</p> <p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik konstaton se shkalla e lirisë të nivelit akademik është e pa cenuar dhe se IAL i motivon që ata të jenë edhe më shumë të angazhuar për fushat e kërkimeve, ndërsa asnjë ndërhyrje në proceset e mësimdhënies nuk është identifikuar. IAL ka rregulloret e brendshme Institucionale dhe statutin të cilat sigurojnë shkallën e lirisë akademike të stafit.</p> <p><i>RVB; Takimet e GVJ ne IAL; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Workshopt, aktivitetet e ndryshme kur përfshihen dhe studentët mund të thuhet se janë motivimi më i mirë për studentët që përveç përfitimit të dijeve, të ndjehen aktorë dhe faktorë në mjedisin e përbashkët të Universitetit. Në shumë projekte të Universitetit vlerësohet se pjesëmarrja e studentëve ka qenë thelbësore. Këtu vlen të përmenden raste që megjithëse fatkeqësie u dhanë mundësi studenteve të praktikojnë dijet e tyre në terren (rasti i tërmetit të 2019).</p> <p>IAL ka edhe buletin e vet ku mund të publikohen punime të punuara nga studentët si dhe stafi akademik i U_POLIS, me revistv periodike shkencore FORUM A+P. Organizimi i workshopeve, puna në Laboratore brenda IAL si dhe bashkëpunimet institucionale ndihmojnë studentët në</p>

	<p>këtë program të studimit, ndërsa brenda programit të studimit, kurrikula përmban lëndën e workshopeve.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/256</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr. 14; Aneksi Nr. 2.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi në veçanti mund të vlerësohet për fokusin gjithëpërfshirës dhe ndërdisiplinor. Profesionistët dhe studentët kanë qenë shpesh të angazhuar në panele ku janë diskutuar politika por dhe ndryshime thelbësore në këtë sektor.</p> <p>Bashkëpunimet e IAL janë dëshmuese dhe tregojnë rritjen e mundësive të metodave në mësimdhënie bashkëkohore si dhe modernizimin e programeve të studimeve sipas zhvillimeve në kushte reale. Përveç kësaj në strategjinë e zhvillimit, Universiteti vë në prioritet aspektet e çështjeve të avancimeve institucionale – stafit akademik sipas trendëve bashkëkohore.</p> <p><i>Aneksi Nr. 3; Aneksi Nr. 14; Aneksi Nr. 34; Aneksi 32..</i></p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Njësia bazë krahas mbështetje financiare nga projekte apo grante kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet projekteve të cilat zhvillohen në Universitetin POLIS, ka një mbështetje financiare nga Universiteti që propozohet nga Njësia bazë dhe miratohet nga strukturat e Universitetit dhe që kryesisht shërben për rritje dhe zhvillim akademik të individit, apo një grupi profesionistësh.</p> <p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik vërtetoi se sigurohet mbështetje institucionale për kërkimet shkencore, qofshin mbështetje akademike ashtu edhe financiare.</p> <p><i>Aneksi Nr.4; Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 17; Aneksi Nr. 34.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk është përmbushur</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të</p>	<p>Grupet lëndore janë me përmbajtje shkencore të thelluar. Me grupin e lëndëve të karakterit profesional mund të realizohen hulumtime shkencore.</p> <p>GVJ konstaton se ky program studimi është i zhvilluar në më gjatë se një dekadë nga e kaluara dhe laboratorët ekzistuese edhe mund të konsiderohen me mundësi që t’ju ofrojnë stafit akademik dhe studentëve hulumtime shkencore të avancuara mirë Universiteti duke qenë i profiluar me kryesisht shkencat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 36

<p>programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>inxhinierike dhe arkitekturore atëherë rritja e kapaciteteve infrastrukturore të Laboratorëve të mendohet si kërkesë e domosdoshme e kohës.</p> <p>IAL në vazhdimësi mbështet grupet lëndore apo projektet kërkimore shkencore të cilat në pjesën më të madhe të rasteve vijnë si propozime nga vetë stafi dhe që në të shumtën e rasteve zhvillohen me një rrjet të gjerë partnerësh lokalë, rajonalë apo evropianë. Disa nga lëndët/ modulet e këtij programi mbulohen në shumë raste me pedagogë të huaj, si pjesë e bashkëpunimeve që Universiteti ka.</p> <p>U_POLIS ka një reputacion shumë të mirë përse i përket marrëveshjeve institucionale. Janë shumë universitete me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.34</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në strategjinë e hartuar të Universitetit për periudhën 2021-2026, janë të përfshira mënyrat e zhvillimit të kërkimit shkencor duke insistuar në përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Në bazë të evidencave të ofruara nga UPOLIS, aktivitetet institucionale lidhur me mundësinë e krijimit të kushteve për hulumtime janë në nivel të kënaqshëm. Në të gjitha aktivitetet– marrëveshjet e arritura janë të përfshirë personeli akademik.</p> <p>Njësia përgjegjëse vihet re se është e angazhuar për t'iu përgjigjur më së mirë kërkesave për kërkim, analiza apo studime të ndryshme. Kjo bëhet e mundur falë një bashkëpunimi mes stafit, studentëve të këtij programi por dhe studenteve të ciklit të tretë.</p> <p>IAL kujdeset që në nivel të departamenteve të hartohet plani vjetor i kërkimeve shkencore i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.45</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Vihet re se Njësia Kërkimore e Qëndrueshmërisë organizon, strukturon dhe përmirëson procesin e kërkimit brenda departamentit. Kjo njësi organizon takime dhe krijon një data basë mbi studimet dhe projektet në të cilat stafi dhe studentet angazhohen, por dhe përcakton apo sugjeron fusha dhe projekte me interes për të ardhmen dhe koordinon proceset e përbashkëta midis departamenteve dhe fakultetit.</p> <p>Janë aktivitete shkencore dhe konferenca të cilat organizohen nga IAL në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare në projektet ndërkombëtare, sikur:</p> <p>Më 26-28 nëntor 2015, u zhvillua në Tiranë, Shqipëri Konferenca Europiane e Gjeo-Mjedisit dhe Ndërtimit, e organizuar nga Shoqata për pjesëmarrjen e tyre dhe leksionet shumë të mira. Konferenca përbëhej nga dy ditë të plota leksionesh dhe diskutimesh.</p>




	Projekti TEMPUS, zhvilluar në POLIS në vitin 2015; Konferenca AESOP; Konferenca "Universiteti, Zhvillimi dhe Inovacioni" forumi i pavarur i Rektorëve si dhe konferenca dhe prezantime të tjera. http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/search/node/konferenca%20language%3Asq <i>Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.17; Aneksi Nr. 34; Aneksi Nr.35.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, por dhe nga vizita në Universitetin POLIS, u konfirmua se përveç formave standardë të mësimdhënies, mësimnxënies si leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike u konstatuan dhe një sërë forma të veçanta të përdorura nga institucioni si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Puna në grup me student të programeve të ndryshme</i> • <i>Prezantimet / ekspozimet publike</i> • <i>Vizita në terren</i> <p>Kjo e fundit karakteristike për institucionin pasi në këtë mënyrë studentëve u jepej mundësi për të pasur kontakt me realitetin dhe problematikat në lidhje me planifikimin dhe shqetësimet e qytetit. Vizitat ishin periodike dhe çdo vit me një tematike të ndryshme si:</p> <p>Vizita të zhvilluara në kuadër të lëndës Planifikim Rajonal:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shkodrën 2016-2017, ○ Lezhën 2018-2019, ○ Durrësin 2019-2020 etj. <p>Vizita të zhvilluara në kuadër të lëndës Ligji dhe legjislacioni urban</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Vizite në bashkinë e Tiranës

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 38




	<p>○ Shërbimet Publike (Vizitë në landfielld-in e Sharrës) etj.</p> <p>Këto janë procese të vazhdueshme për këtë Universitet. Gjithashtu U_Polis zhvillon dhe vizita kulturore edukative, të cilat shërbejnë në socializmin e studenteve sikurse vizita vjetore e Kosovës (2017-2018-2019) etj.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.34.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në strukturën (organogramën) e IAL janë të ndërtuara dhe funksionale zyra të cilat kanë detyrën e përcaktuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së mësimi.</p> <p>Personeli akademik vepron krejtësisht i lirë në përcaktimin e metodologjive të mësimdhënies, duke u koordinuar me departamentin mbi cilësinë dhe vazhdimësinë e mësimdhënies dhe më pas me dekanatin mbi rolin dhe hapësirën në programin e studimit. Ky zinxhir koordinimi është i nevojshëm për të adresuar raportin e metodikave në mësimdhënies, balanca midis lëndëve dhe module por dhe koordinimi me objektivat e mësimdhënies dhe cilësisë së ofrim të programit.</p> <p>NJSBC pjesë e U_POLIS, është monitoruese dhe indikator për rritjen e cilësisë akademike e cila zyre punon sipas rregullores institucionale të miratuar. Brenda institucionit bëhen vlerësime të mësimdhënësve nga studentët dhe në varësi të rezultateve IAL reagon. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti i Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.40; Aneksi Nr.41</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në program ka eksperiencë profesionale dhe mbështetje të plotë nga njësia bazë dhe ajo kryesore për përmirësimin dhe zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies</p> <p>Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një-drejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda orijetojnë drejt formave të mësimi me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve.</p> <p>Profesori i lëndës vepron krejtësisht i lirë në përcaktimin e metodologjive të mësimdhënies, duke u koordinuar me departamentin mbi cilësinë dhe vazhdimësinë e mësimdhënies dhe më pas me dekanatin mbi rolin dhe hapësirën në programin e studimit.</p> <p>Në këtë aspekt lënda është subjekt i vazhdueshëm përmirësimi të cilësisë, forma e mësimdhënies përcaktohet nga pedagogu, koordinohet nga departamenti dhe miratohet nga dekani.</p>

	<p>Në takimet e GVJ me studentët dhe me mësimmshënësit vlerësuam se pjesa dërmuese e Studentëve bën vlerësimin e lëndës dhe mësimmshënësit sipas kriterëve të përcaktuara nga Institucioni. Këto vlerësime janë autonome dhe të paanshme. Ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.41.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimmshënënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të dhënat e procesit të vlerësimit nga NJSBC prezantohen në mbledhje të hapur të Senatit Akademik në mënyrë të detajuar (në nivel departamenti dhe Fakulteti).</p> <p>Kurse vlerësimi personal për secilin pedagog përcillet në mënyrë individuale.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve të studentëve për profesorët janë të organizuara në mënyrën institucionale duke i analizuar të njëjtat nga Dekani i Fakultetit deri te Rektori i U_POLIS për të marrë masa konkrete.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.37.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimmshënënie</p>	<p>Krahas prezantimit të rezultateve të vlerësimit rëndësi ju jepet dhe komenteve të bëra nga studentet dhe stafi (<i>peer review</i>) duke theksuar përvojat e mira dhe duke nxitur diskutimet dhe shtrirjen e tyre në të gjithë institucionin.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.37.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimmshënënie, mësimmshënënie dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimmshënënie, mësimmshënënie dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga konsultimi i syllabuseve por dhe nga takimi me stafin dhe studentet, GVJ konstatoi se ka një larmi metodash dhe formash të mësimmshënënie të aplikuara në këtë program studimi si workshope, raste studimore, projekte në grupe, vizita në terren, etj.</p> <p>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 6-12 orë mësimore në javë

<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Seminare 6-8 orë mësimore në javë - Studio/projekt/workshope 12-18 orë mësimi - Laboratorë 18-25 orë mësimore - Ushtrime/Detyra 1-d orë - Praktikë 20-25 orë <p>Fokusi tek format e mësimdhënies që zhvillojnë aftësitë teknike e praktike te studenteve janë shumë të përshtatshme për fushën dhe nivelin e këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me mësimdhënësit konstatohet se përdorimi i metodologjive alternative dhe bashkohore në mësimdhënie janë evidente dhe aplikohen rëndomtë nga mësimdhënësit. Rasti i mbajtjes së mësimi virtual përgjatë kohës së pandemisë ishte sfidues.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Një nga pyetjet e pyetësorit të vlerësimit të mësimdhënies nga studentet ka të bëjë pikërisht me përshtatshmërinë e metodologjive të mësimdhënies. Në rast se ky vlerësim rezulton në nevojën për të përmirësuar këtë aspekt, kjo del e qartë nga vlerësimi. Për më tepër pyetësori ka edhe hapësirë për komente nga ana e studentëve, të cilët në çdo rast kanë një kontakt të drejtpërdrejtë me koordinatorin e programit të studimit të cilit i përcjellin mendimet e tyre si dhe nëpërmjet përfaqësuesve të studentëve në Senatën Akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nëpërmjet një projekti Erasmus të financuar nga BE, Polis punon dhe për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies për studentet me aftësi të kufizuara.</p> <p>Stafi ka vazhdimisht qasje në trajnime ose vizita studimore të mundësuar nga numri i lartë i projekteve të universitetit, të cilat kanë fokus parësor rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kompetencave të stafit mësimdhënës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>U_POLIS, mbështet njësitë akademike të saja përmes së cilave përkrahin personelin akademik në mundësinë e diversitetit të mësimdhënies, krijimi i platformës elektronike për ligjëratat virtuale, takimet e rregullta me studentët analiza e nevojave të tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Puna e mësimdhënësve për punën me studentë në rastet e punimit të diplomave Master janë dëshmi për përsosmërinë e mësimdhënies dhe rritjes së efikasitetit të nxënies.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga</p>	<p>Përgatitja e stafit akademik efektiv dhe me kontratë vlerësuar edhe nga CV-të e tyre personale është adekuat programit të studimeve Master Shkencor i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p>Programi i studimit MSc PMU, me lëndët mësimore të cilat janë pjesë e kurrikulës, stafi akademik i rregullt dhe ndihmës ju ofronin studentëve</p>

<p>mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>mundësi të mëdha për shpjegime për rastet studimore të dala edhe nga praktikatat e realizuara në institucionet vendore.</p> <p>Gjatë takimeve të GVJ në IAL dhe me takimet e ndara me mësimdhënësit dhe studentët u vërejt se niveli i ofrimit të informatave dhe nxitja e studentëve për të u kyçur në proces të nxënies ishte mbresëlënëse.</p> <p>Dinamika e programit të studimit, vizitat në terrene – objekte, duke parë praktikën e mirë dhe jo të mirë, defektet e objekteve të shkaktuara nga tërmeti, shkalla e dëmtueshmërisë, lidhja me pjesët teorike të mësimave në auditor, ushtrimeve, laboratorëve, puna praktike e studentëve janë tërësi e këtij programi të studimit për të cilën studenti duhet të jetë pjesë aktive e aktiviteteve akademike.</p> <p><i>RVB; Shënimet në vizitë; Aneksi CV Personeli Akademik_FPMU; Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.15; Teza dhe Projekt Diploma; Aneksi Nr.25; Aneksi Nr.14.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

<p>Standardi III.3</p>																															
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>																															
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>																														
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Universiteti POLIS, ka një infrastrukturë më moderne, cilësore, të pastër, e organizuar në përputhje me kërkesat e një institucioni të lartë arsimor të cilat janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave mësimore.</p> <p>Duke ju referuar materialeve të IAL atëherë sipërfaqet e hapësirave janë si më poshtë:</p> <table data-bbox="587 1429 1332 1901"> <tr> <td>Kati Zero</td> <td>Sipërfaqja 1799 m²</td> </tr> <tr> <td>Mjedis i përbashkët</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Korridori</td> <td>175 m²</td> </tr> <tr> <td>Sallë kompjuterësh</td> <td>180 m²</td> </tr> <tr> <td>Korridoret në katin zero</td> <td>327 m²</td> </tr> <tr> <td>Mjediset për veprimtaritë akademike</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Klasa A2</td> <td>75 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A3</td> <td>120 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A4</td> <td>75 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A5</td> <td>120 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A6</td> <td>75 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A8</td> <td>75 m²</td> </tr> <tr> <td>Klasa A10 Laboratori i Modelimit</td> <td>30 m²</td> </tr> <tr> <td>Laboratori I mjedisit</td> <td>75 m²</td> </tr> <tr> <td>Innovation Factory IF</td> <td>60 m²</td> </tr> </table>	Kati Zero	Sipërfaqja 1799 m ²	Mjedis i përbashkët		Korridori	175 m ²	Sallë kompjuterësh	180 m ²	Korridoret në katin zero	327 m ²	Mjediset për veprimtaritë akademike		Klasa A2	75 m ²	Klasa A3	120 m ²	Klasa A4	75 m ²	Klasa A5	120 m ²	Klasa A6	75 m ²	Klasa A8	75 m ²	Klasa A10 Laboratori i Modelimit	30 m ²	Laboratori I mjedisit	75 m ²	Innovation Factory IF	60 m ²
Kati Zero	Sipërfaqja 1799 m ²																														
Mjedis i përbashkët																															
Korridori	175 m ²																														
Sallë kompjuterësh	180 m ²																														
Korridoret në katin zero	327 m ²																														
Mjediset për veprimtaritë akademike																															
Klasa A2	75 m ²																														
Klasa A3	120 m ²																														
Klasa A4	75 m ²																														
Klasa A5	120 m ²																														
Klasa A6	75 m ²																														
Klasa A8	75 m ²																														
Klasa A10 Laboratori i Modelimit	30 m ²																														
Laboratori I mjedisit	75 m ²																														
Innovation Factory IF	60 m ²																														

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 42




Laboratori i Efiçencës Energjetike	70 m ²
Laboratori i Fotografisë	10 m ²
Mjediset për veprimtaritë administrative	
Zyra e Informacionit	10 m ²
Sekretaria mësimore	47 m ²
Zyra juridike/Protokolli	25 m ²
Zyra e financës dhe e Shërbimeve	25 m ²
Zonat e shërbimit	
Mjedis për fotokopjim	41 m ²
Arkiva	43 m ²
Magazinat	27 m ²
Mirëmbajtja	30 m ²
Nyje hidrosanitare për Personelin	11 m ²
Nyje hidrosanitare për Studentët	68 m ²
Nyje hidrosanitare për personat me aftësi të kufizuar	5 m ²
Kati i parë	Sipërfaqja 1801 m ²
Mjedis i përbashkët	
Korridori Kati 1	348 m ²
Mjediset për veprimtaritë akademike	
Laboratori 3D MAC Lab (Mezanina 1)	52 m ²
Laboratori PC Lab (Mezanina 2)	85 m ²
Klasa B1	72 m ²
Klasa B3	142 m ²
Klasa B4	72 m ²
Klasa B5	72 m ²
Klasa B6 Laboratori i Mjedisit	175 m ²
Klasa B8	145 m ²
Qendra MAD	172 m ²
Mjediset për aktivitetet administrative	
Rektorati/ Administratori	45 m ²
Kancelari	16 m ²
Sekretaria e Rektoratit	18 m ²
Zyra për Personelin	50 m ²
Zyra e PhD	50 m ²
Box	18 m ²
Zonat e shërbimit	
Salla për Bibliotekë në POLIS	155 m ²
Salla interneti	23 m ²
Nyje hidrosanitare për Personelin	14 m ²
Nyje hirosanitare për Studentët	70 m ²
Nyje hidrosanitare për Invalidët	7 m ²
Kati i dytë	Sipërfaqja 1541 m ²
Mjedis i përbashkët	
Korridori i Katit 2	385 m ²
Mjedise për veprimtaritë akademike	
Klasa C1	216 m ²
Klasa C2	140 m ²
Klasa C3	66 m ²
Klasa C4	140 m ²
Klasa C6	140 m ²
Mjedise për	
Dekani i FAD	11 m ²
Dekani i FPMMU	12 m ²

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 43

	<p>Zv/dekani i FAD, FPMMU 17 m² NJBSC dhe Koordinatorët e Programeve Master 23 m² Zyrë e personelit 50 m² Zyrë për palë të treta (CO-PLAN) 150 m² Zyrë për palë të treta (Metro_POLIS) 77 m² Box 12 m² Zonat e shërbimit IT 9 m² Nyje hidrosanitare për Personelin 15 m² Nyje hidrosanitare për Studentët 72 m² Nyje hidrosanitare për Invalidët 6 m² Kati i tretë Sipërfaqja 615 m² Zonat e shërbimit Kantina 563 m² Nyje hidrosanitare për Studentët 28 m² Nyje hidrosanitare për Invalidët 7 m² Mjedisi i jashtëm Oborr 3,864 m² Parkim nëntokësor 1,400 m² Sipërfaqe totale 11,020 m²</p> <p>Sipërfaqja e përgjithshme e ambienteve të IAL për stafin është 11,020 m² Bazuar në shënimet e IAL, kjo sipërfaqe e objektit është e mjaftueshme për numrin e studenteve marr parasysh që në nivel vendi numrat e studenteve në ardhje janë duke u ulë.</p> <p><i>Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1 deri 42.6, Planimetri</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>U_POLIS ka gjithë infrastrukturën e nevojshme për të realizuar kërkesat e nevojshme të studentëve për ngritjen e kapaciteteve praktike, nëpërmjet punës në laboratorë dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucione dhe agjenci për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1 deri 42.6, Planimetri</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>U_POLIS ka sistem të mirë të ndërtuar përsa i përket bibliotekës. Brenda IAL funksionon Biblio_POLIS e cila siguron tituj dhe literature duke përfshi libra dhe materiale të printuara dhe elektronike, të cilët i përkasin disiplinave të ndryshme por, kryesisht, degëve të Planifikimit Urban, Shkencave Kompjuterike, Art dhe Dizajnit, Arkitekturës, Studimeve Mjedisore, Shkencave Sociale, Inxhinieri Ndërtimi, Shkenca Ekzakte, etj. Këto materiale bashkëkohore përfshijnë tekste të rëndësishme të shkruara në gjuhët primare të folura e të kuptuara në Shqipëri: Shqip, Anglisht, Italisht.</p> <p>Përveç Biblio_POLIS, me fond mbi 10.000 tituj librash në format fizik, IAL ka krijuar mundësinë e qasjes në dy nga libraritë më të larmishme në nivel ndërkombëtar, sikurse janë EBSCO dhe JSTOR. Çdo anëtar i komunitetit POLIS, mund ti përdori këto thesare për të thelluar njohuritë dhe dijet në</p>




	<p>fushat e interesit. Ju mund të qasja këto dy biblioteka online duke klikuar mbi secilën prej tyre. Përdorimi i tyre është shumë i lehtë dhe tepër komod.</p> <p>GVJ konstaton se IAL përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. Sistemi mundëson menaxhimin e integruar të të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Sistemi menaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, syllabusin e lëndës dhe materialet didaktike të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit/lëndë, vlerësimet e studentit (vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar/lëndë) etj. Studenti në kohë reale ka qasje në ecurinë akademike të tij (lista e notave të lëndëve të shlyera, detyrimet akademike të pashlyera etj.). http://www.universitetipolis.edu.al/</p> <p><i>Aneksi Nr.45</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës u konstatua se Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10185 titujsh në përputhje me programet që ofron.</p> <p>Tematikat e bibliotekës së universitetit janë të ndara kryesisht në tre fusha kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Arkitekturë 2- Art Dizajn 3- Planifikim Urban 4- Studime Mjedisore 5- Shkenca Kompjuterike 6-Eficencë Energjetike 7-IT 8- Inxhinieri Ndërtimi <p>Si dhe studenteve përveç literaturës fizike dhe asaj elektronike kishin mundësi e marrjes së leksioneve në formën e dispensave (materiale mësimore të përgatitura për çdo lëndë nga lektori përgjegjës lëndës, për përdorim të brendshëm institucional)</p> <p>Janë numër i konsiderueshëm i literaturës që ju ofrohen studentëve për nevojat e studimeve dhe në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj. Platformat e e-library në të cilat IAL është parapaguar ofrojnë avantazhe të mëdha për studentët. GVJ në takim me studentët vlerësoj punën e studentëve në shfrytëzim të literaturës që ofrohet nga IAL.</p> <p><i>Aneksi Nr.45</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të</p>	<p>Biblio_POLIS përfshin libra dhe materiale të printuara dhe elektronike, të cilët i përkasin disiplinave të ndryshme por, kryesisht, degëve të Planifikimit Urban, Shkencave Kompjuterike, Art dhe Dizajnit,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 45

<p>programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Arkitekturës, Studimeve Mjedisore, Shkencave Sociale, Inxhinieri Ndërtimi, Shkenca Ekzakte, etj. http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/52</p> <p>Këto materiale janë të qasshme në hapësirat e bibliotekës që kanë krahas librave fizike dhe kompjuterë ku mund të bëhet kërkim dhe një sallë leximi.</p> <p>Biblioteka e institucionit ofron mbi 1000 tituj, të ndara neper seksione, duke përcaktuar titujt e formimit të përgjithshëm, nga ato të profilit.</p> <p>Në takimet me stafin akademik, rezulton se literatura e detyruar gjendet në bibliotekë.</p> <p><i>Aneksi Nr.45</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Studentet e këtij programi kanë mundësi qasjeje në të dy bibliotekat në platforma elektronike</p> <p>https://www.jstor.org/ dhe http://eds.b.ebscohost.com/</p> <p>JSTOR është një bibliotekë dixhitale që përmban revista dhe libra të dixhitalizuar dhe dixhitale. POLIS është abonuar në tre volume të Arts & Science Volumes dhe në koleksionin e Qëndrueshmërisë.</p> <p>Përveç JSTOR, POLIS i ofron mundësi studentëve për tu qasur edhe bibliotekën dixhitale (http://eds.b.ebscohost.com/)</p> <p>Të dyja këto biblioteka përmbajnë literature në gjuhë të huaj, ato shërbejnë si platforma shumë të rëndësishme ndihmuese ku studentët e këtij programi mund të gjejnë materiale ndihmëse/ plotësuese etj.</p> <p>Ndërsa për stafin akademik shërbejnë si një burim i rëndësishëm për përgatitjen e leksioneve, dispensave dhe kërkimeve shkencore akademike në këtë fushë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.45</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>IAL ka investuar dhe synon të vazhdojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.</p> <p>U_POLIS aktualisht ka 8 laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA • Laboratori i MAC • Laboratori i Qeramikës • Laboratori i Pikturës/Ilustrimit • Laboratori i Prototipizimit – i pasuruar me shume pajisje te reja. • Laboratori i Fotografisë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 46




	<ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i Eficiences Energjetike • Laboratori i ri kompjuterësh për lëndë – digjital Architecture <p>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit Master i Shkencave i integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p>GVJ konstaton se IAL disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/seminareve janë të pajisura me PC, projektorë. Biblioteka dhe laboratorë. Për përgatitjen e diplomave studenti shfrytëzon si bazën e literaturës në hard copy ashtu edhe literaturë nga interneti apo biblioteka të tjera on-line në mjediset e bibliotekës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.45; Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1; Aneksi Nr.42.2; Aneksi Nr.42.3; Aneksi Nr.42.4; Aneksi Nr.42.5; Aneksi Nr.42.6.</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>IAL ka krijuar llogari Universitare në platformën G suite (<i>G Suite Education, Google</i>) e cila lejon përdorimin e Google Classroom, për hapjen e një klase virtuale dhe se studentët kanë të krijuar akontin (studenti@universitetiPOLIS) duke ju krijuar qasje në literaturë si dhe shërbime dhe njoftime në kohë reale.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimin G suite, pedagogët përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2610</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët dhe stafi përdorin sistemin (<i>G Suite Education, Google</i>) për shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës. Gjithashtu përdoren platforma GoToMeeting dhe email zyrtar në domain http://www.universitetipolis.edu.al/</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2610</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>IAL ka të hartuar rregulloren e Diplomimit e cila i referohet programit të Studimit Master Shkencor i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban. Kjo rregullore i ndihmon dhe udhëzon studentët mbi rregullat, afatet e realizimit të diplomës si dhe me standardet e realizimit të punimit.</p> <p>Me urdhër të MASR Nr. Prot. 2432/10 të datës 10.09.2020 rregullohet modeli i diplomës që respektohet nga IAL, përkatësisht nga FPMMU për programin MSc PMU. FPMMU, përkatësisht DPMU, programi i MSc PMU, ka të hartuar syllabusin e Teza dhe Projekt Diploma i cili përmban aktivitetet e studentit që duhet të përmbushen gjatë semestrit të dhjetë - të fundit të studimeve.</p> <p>FPMMU, përkatësisht Departamenti i Planifikim dhe Menaxhim Urban me stafin akademi të tij zhvillojnë procedura bashkëkohore të punës me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


faqe 47




	<p>studentët për hartimin e diplomave, puna intensive, progresi i punës i përcjellur nga stafi akademik në mënyrë të vazhdueshme, ndihma dhe përkrahja me literaturë janë veprimet që GVJ i gjeti gjatë takimeve me stafin dhe studentët.</p> <p><i>Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.15; Teza dhe Diploma.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>U_POLIS monitoron plotësimin e standardeve të mësimdhënies, duke ju nënshtruar periodikisht proceseve të akreditimit.</p> <p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë Universitetit POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Arkitekture Dizajn, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të studimit për Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.</p> <p>Në përputhje me objektivat strategjike të IAL ka qartë të përcaktuara edhe në Statut dhe rregullore, prioritetin për sigurimin e cilësisë, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal). NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Rektori i U_POLIS ka përcaktuar koordinatore të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikëqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC-n. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparura në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.; Aneksi Nr.17, Aneksi Nr.30; Aneksi Nr.37.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Hapësirat, Laboratorët përkatësisht Infrastruktura e IAL, asetet brenda Institucionit si dhe stafi akademik me veprimtarinë e vet duke përdorur metoda praktike dhe të avancuara e bëjnë këtë program të studimeve jashtëzakonisht të lakmuar për të studiuar.</p>

	<p>GVJ vlerëson përpjekjet e vazhdueshme që Institucioni inkurajon personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie duke u përshtatur me zhvillimet e programit të studimit.</p> <p>Organizimi i konferencave të ndryshme ndërkombëtare, Workshop-eve nga IAL janë tregues dhe matës të mundësive që Universiteti ju ofron stafit akademik dhe studentëve.http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/53</p> <p>Gjithashtu Laboratorët, lab i projektimit dixhital i përditësuar me pajisje dhe programet të reja shërbejnë për arritjen e kompetencave të studentëve njëkohësisht edhe ngritjes së cilësisë në mësimdhënie nga pedagogët e programit të studimit MSc PMU.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.17.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Falë mobiliteteve dhe shkëmbimeve me institucione të huaja partnere, stafi vjen me ide të reja për zhvillimin e mësimdhënies të cilat pas diskutimit në departament miratohen dhe fillojnë implementimin. Disa nga metodat e përmendura janë përdorimi i teknologjive të reja (VR/AR), software të reja por dhe metoda si ‘role-playing’ sipas RVB.</p> <p>Hapësirat, Laboratorët përkatësisht Infrastruktura e IAL, asetet brenda Institucionit si dhe stafi akademik me veprimtarinë e vet duke përdorur metoda praktike dhe të avancuara e bëjnë këtë program të studimeve jashtëzakonisht të lakmuar për të studiuar.</p> <p>Gjithashtu Laboratorë të projektimit dixhital, i përditësuar me pajisje dhe programet të reja shërbejnë për arritjen e kompetencave të studentëve njëkohësisht edhe ngritjes së cilësisë në mësimdhënie nga pedagogët e programit të studimit MSc PMU.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.8. Aneksi Nr.17.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në fushën e kërkimit shkencor stafi i ri ka mundësi rritje dhe kualifikimi nëpërmjet doktoratës, kurse stafi tjetër nëpërmjet projekteve kërkimore. Kjo gjë doli e qartë nga takimi me stafin.</p> <p>Institucioni ka të zhvilluara aktivitetet shkencore, studimore, hulumtuese, të mbështetura në shumë faktor nga të cilët meritohet janë padyshim përveç personelit Akademik edhe pjesa tjetër e personelit që përcjell punën me Studentët. Gjithashtu edhe personeli tjetër ndihmës janë Laborantët që menaxhojnë me laboratorët dhe pajisjet e tyre, mirëmbajtësit e ambienteve shkollore (vlen për tu theksuar se pastërtia e ambienteve të mësimi, tualeteve, banjave, etj. janë në nivel shumë të kënaqshëm) janë kontribuues në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm. Studentëve ju ofrohet edhe zyra e IT-së e cila asiston në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë të interesuarit.</p>




	<p>Gjatë vizitës së GVJ në ambientet e IAL, përkatësisht laboratorëve u vërejt puna me studentët në proces të mësim nxënies cilësore.</p> <p>Të gjitha këto shërbime që ju ofrohen Studentëve, kanë për qëllim që të jetë siguruar cilësia e mësimdhënies, dëshira për të studiuar thellësisht dhe arritja e kompetencave profesionale në nivelin çfarë kërkon tregu vendor dhe i jashtëm.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.42. Syllabus Laboratore - Planifikim rregullator 1 dhe 2</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në takim me dekanin e Fakultetit PMMU dhe drejtuesen e Departamentit PMU, GVJ u informua se stafi mësimdhënës, sidomos personeli i ri i rekrutuar rishtazi i nënshtrohet disa takimeve informuese por dhe trajnimeve për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimit të metodologjive bashkëkohore.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.33.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se në statut dhe strategjinë e zhvillimit, institucioni përcakton se personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik</p> <p>U_POLIS ofron mbështetje institucionale duke vënë në dispozicion të personelit akademik infrastrukturë mbështetëse (laboratorë, ambiente, sisteme/ programe informatike, biblioteka etj.</p> <p>GVJ, gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik, konstaton se Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, periodikisht në fund të vitit akademik analizon punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet dhe mangësitë, si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen</p> <p><i>Aneksi Nr.2</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>NJSBC dhe Fakulteti vënë në fokusin e tyre metodat e mësimdhënies. Referuar takimeve me stafin dhe NJSBC evidentohet te jene organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, workshop-e etj., për metodat e reja, me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik të U_POLIS.</p> <p>Sfidat që solli periudha e pandemisë ishin një shtyese që ndihmoi institucionin në implementimin e metodave novatore të mësimdhënies.</p> <p>Projektet Erasmus pjesë e së cilave ishte dhe është IAL kanë dhënë shtytje dhe mundësi afrimi të metodave të reja të mësimdhënies.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.34</i></p>




<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në IAL në takimet me stafin akademik, prezent ishin edhe staf ndërkombëtar i angazhuar në programin e studimit MSc PMU.</p> <p>Nga bashkëpunimet e U_POLIS me institucionet ndërkombëtare nga GVJ vërehej përfshirja e pedagogëve të huaj të cilët organizonin mësimin në gjuhë angleze.</p> <p>IAL ka të realizuara marrëveshje bashkëpunimi me institucione nga të cilat ftonin edhe mësimdhënës për tematika shumë specifike.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.34; Aneksi Nr.35.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Të gjitha rregullat dhe format e vlerësimit të studentëve përcaktohen në Rregulloren Didaktike, e cila është e publikuar në sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave nga studentët.</p> <p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i qasen në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton te jete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi - 25 % Test teorie - 56 % Projekt - 10 % Angazhimi dhe cilësia ne përgatitje. <p>GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është e qëndrueshme dhe e vazhdueshme gjatë zhvillimit të mësimin.</p> <p><i>RVB: Aneksi Nr.19 Syllabusi Gjeometri dhe dokumentim Grafik.pif</i></p>




<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloret e U_POLIS dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton te jete realizuar një proces i tille.</p> <p>Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Sipas Rregullores se provimeve, testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj.), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmblylëse për mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Gjatë takimeve të GVJ me studentët e programit të studimeve Master Shkencor i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban vërtetoj se studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të mësimi.</p> <p>Universiteti POLIS vlerësohet se realizon testim të njohurive të studentit gjatë gjithë vitit. Kjo është përcaktuar dhe në Rregulloren Didaktike të cilën kemi marrë në shqyrtim dhe që është dokumenti rregullator bazë që garanton vlerësimin e drejtë dhe transparent bazuar në meritën e çdo student. Pikërisht kësaj rregulloreje i referohet dhe stafi akademik i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 52




	<p>Universitetit, ndërsa rezultatet e çdo vlerësimi bëhen publike nëpërmjet sistemin Pitagora. Hedhja e çdo vlerësimi bëhet nga pedagogu në sistem dhe studentët marrin vlerësimin në kohë reale. Një procedurë e tillë zbatohet dhe për vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>IAL ndër vite ka operuar me platforma të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, ndërsa vihet re se ky sistem është konsoliduar më shumë gjatë periudhës së pandemisë. Më konkretisht në platformën Google Class Room është krijuar një hapësirë e posaçme për të hedhur vlerësimin, mungesat dhe angazhimin e studentit pas çdo seance mësimore, ndërkohë që nëpërmjet Google Classroom “assignment” studentët marrin tezë individuale dhe me kamera të hapura e plotësojnë atë, ose realizojnë provim me goje (e përdorur kryesisht gjatë periudhës së pandemisë). Vihet re se platforma e mësipërme është shtesë e sistemit të vlerësimit dhe testimit elektronik, që në fakt zbatohet në këtë Universitet që nga vitit 2006.</p> <p>U_POLIS ka një sistem elektronik të ruajtjes së shënimeve të studentëve i cili është i qëndrueshëm dhe shumë funksional, ndërsa ju shërben studentëve dhe mësimdhënësve G store – Google Clasroom si dhe platforma Pitagora e cila ju mundëson studentëve përmes qasjes të shohin informatat lidhur me vlerësimet e tyre, lëndët dhe informatat në kohë reale nga IAL.</p> <p>https://polis.pitagora.rash.al/login</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.8</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e IAL-së.</p> <p><i>Aneksi Nr.10.</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Universiteti posedon të gjithë infrastrukturën për të zhvilluar një mënyrë transparente vlerësimin e dijeve. I kushtohet shumë rëndësi ruajtjes së të dhënave të studentit dhe konfidencialitetit. Studenti posedon kredencialet e tij me të cilat vetëm ai ka qasje në hapësirën e tij të dedikuar.</p> <p>Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin</p>




	<p>e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit.</p> <p><i>Shënime në vizitë; Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.8</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi final merret nga studenti në kohë reale nëpërmjet sistemit, ajo që u vërejt është që vlerësimi i vazhduar dhe në veçanti komunikimi mes stafit dhe studentëve është mjaft i shëndetshëm. Gjatë gjithë periudhës studentit i jepet mbështetje, këshilla për t'u përmirësuar në të ardhmen, gjë që ndikon më pas dhe në vlerësimin final.</p> <p><i>Aneksi Nr.7</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Një gjë e rëndësishme që mund të evidentohet është moslejimi në mënyrë kategorike i kopjimit në detyra apo provime. Njëzëri stafi akademik është kategorik dhe i prerë në raste të tilla. Nëse kjo ndodh studentit jo vetëm përjashtohet nga provimi, por rasti i kalon Këshillit të Etikës. Ndërkohë detyrat, projektet e ndryshme, artikujt para vlerësimit i nënshtrohen dhe kontrollit në sistemin e plagjiaturës Turnitin.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe Rregullores së Etikës.</p> <p><i>Aneksi Nr.31</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem notash kaluese nga 10 deri në 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi Pitagora, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. https://polis.pitagora.rash.al/login</p> <p>GVJ konstaton se vlerësimi i studentëve publikohet në mënyrë të detajuar, duke përfshirë në tabelë të gjithë komponentët e vlerësimit, ndërsa koha e dhënies së vlerësimit është tre ditë pas dhënies së provimit.</p> <p>Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; Aneksi 46, Sistemi i platformës Pitagora</i></p>

<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vlerësimit, vihet re se respektohet plotësisht e drejta e studentëve për të kontestuar vlerësimin e marrë. Ka një procedurë të mirë përcaktuar në raste të tilla dhe më konkretisht studenti dorëzon pranë Sekretarisë mësimore kërkesën zyrtare. Sekretaria njofton Dekanatin përgjegjës, dhe në rastet kur kërkesa pranohet bëhet ngritja e Komisionit të Vlerësimit i cili shqyrton ankesat e studentëve. Në rast të ndryshimit të vlerësimit hartohet procesverbali përkatës dhe për këtë rezultat të ri ose jo njoftohet Sekretaria Mësimore dhe studentët e përfshirë në ri-vlerësim. I gjithë dokumentacioni pjesë e këtij procesi ruhet në Sekretarinë mësimore.</p> <p>Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.</p> <p><i>Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ, Universiteti POLIS na vuri në dispozicion të gjithë dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet e tyre apo rishqyrtime të vlerësimit. Procedura është transparente për të gjithë palët e përfshira në proces dhe poashtu e arkivuar me kujdes.</p> <p>Kërkesa për ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në U_POLIS.</p> <p><i>Aneksi Nr.7</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7 Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike shkencore në fushën e arkitekturës, praktiken profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për mundësinë e vazhimit të studimeve të ciklit të trete.</p> <p>Syllabuset e lëndës paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse.</p> <p>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf i akademik përfshin studentet në veprimtari jashtëkurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e ndërtimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 55

	<p>Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore të stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.</p> <p>IAL ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, IAL punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p> <p>Projektet kërkimore kanë në fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><i>Aneksi Nr.19, Aneksi Nr.14.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Ne raport e hartuar nga GVB, por dhe nga vizita ne institucion u konstatua se departamenti i ofronte studenteve informacion te detajuar mbi Sistemet Gjeografike te informacionit qe lidhen me profesionin e planifikimit.</p> <p>Punimi i Tezave dhe diplomës në Planifikim, Menaxhim Urban për kohën e sotshme pa përdorimin e softwer-ve profesional është e pa mundur të paramendohet, prandaj edhe FPMMU dhe DPMU janë shumë të vetëdijshëm për këtë çështje, prandaj progresi i studentëve është në kohë reale.</p> <p><i>Aneksi Nr.40.1, Aneksi Nr.51.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të fituara në çdo lëndë kryhej në disa nivele, nëpërmjet vlerësimit të pedagogut dhe performancës së mësimdhënies, më pas studenti në përputhje me termat e referencës së detyrës përfundimtare, provimit, punimit në grup etj., përfiton një vlerësim pikësorë të bazuar në syllabusin e lëndës mbi performacën e tij në komponentët e vlerësimit të cilët i bëhen të ditur studentit në fillim të lëndës.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur ne syllabus. Këto elemente qe detajohen ne çdo lende janë pjese e objektivate te përgjithshme te programit.</p> <p><i>Aneks.7: Syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga takimi me stafin por dhe me studentet doli ne pah se në përfundim të lëndës studentët kanë në dispozicion kohën për të punuar në detyrën me të paktën dy takime konsultash paraprake, në varësi të lëndës dhe kompleksitetit të detyrës. Për testimin studentet kryejnë seanca përsëritje për njohuritë teorike përgjatë lëndës, teste prove apo ushtrime logjike për të sqaruar konceptet teorike. Të gjithë format e mbështetjes së njohurive të</p>




	<p>studentit janë pjesë integrale e metodologjisë së lëndës dhe ndryshojnë në varësi të lëndës dhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>Aneks. 7: Syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Një mënyrë tjetër e mësimdhënies/mësimnxënies ka të bëjë me Leksionet e hapura, workshop dhe praktika të përbashkëta janë vetëm disa nga praktikat të cilat zhvilloheshin gjatë gjithë vitit akademik nga viti i parë deri në vitin e pestë.</p> <p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca dhe simpoziume workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor.</p> <p>Aktivitetet e U_Polis me institucionet vendore sikur janë “TAW TIRANA Architecture Weeks”, “Tirana Design Weeks” etj. Janë treguesit e matshëm për mësimdhënësit të cilët angazhohen në punëtori, prezantime të hapura dhe aktivitetet tjera jashtë mësimore.</p> <p><i>Aneks.7: Syllabuset e lendeve;</i></p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/search/node/tirana%20language%3Asq</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës u vu re se universiteti disponon laboratorë me infrastrukturë bashkëkohore çka i jep mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale në lidhje me këtë program të studimit.</p> <p>Studentët e programit MSc në Planifikim dhe Menaxhim Urban kanë në dispozicion laboratorë të ndryshëm si dhe mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale. Përsa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar në zhvillimin e praktikave profesionale, gjë që përbën edhe një objeksion gjatë zhvillimit të saj.</p> <p><i>Aneks.7: Syllabuset e lendeve.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Puna në grupe ishte një tjetër mënyrë ndërveprimi i procesit të mësimnxënies, çka i parapërgatit studentët për tregun e punës.</p> <p>Varësisht nga temat e caktuara pune në grupe, puna mund të realizohej me student të programeve të ndryshme.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës.</p> <p>Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e programit MSc PMU.</p> <p><i>Aneksi Nr.14.</i></p>

<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik të programit të studimit kishin qenë ose ishin pjesë e programit të doktoratës, çka kishin pasur mundësi të njiheshin edhe me metodologji të reja të mësimdhënies, forma të reja bashkëkohore të cilat i përdoronin dhe i përcillnin me sukses edhe tek studenti.</p> <p>GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në IAL janë funksionale qendrat kërkimore.</p> <p><i>Takimi i GVJ me mësimdhënësit në ambientet e Laboratoreve</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nëpërmjet strukturës së <i>Innovation Factory</i> dhe laboratorit të ri të fabrikimit dixhital studentët me ide më inovative mbështeteshin për ti avancuar idetë e tyre dhe për prototipizuar ato, që GVJ gjatë vizitë në laboratorë fizikisht kishte qasje në disa prej modeleve 3D të krijuara nga Studentët.</p> <p>U_POLIS ofron një gamë marrëveshjesh institucionale Fakulteteve për mundësi të shfrytëzimit të tyre për interesa të përgjithshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.14.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Fryma e bashkëveprimit dhe metodologjitë e mësimdhënies të ngjashme me universitetet e rajonit por dhe më gjerë, krijonin lehtësi në përshtatjen e studentëve gjatë projekteve Erasmus +, programeve të shkëmbimit, gjë që lehtësonte integrimin e studentëve në universitetin ku shkonin.</p> <p>Të gjitha projektet dhe marrëveshjet mundësojnë mobilitete të studentëve si dhe stafit akademik.</p> <p><i>Aneksi Nr.34</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.8</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar por dhe nga vizita në institucion u vërtetua se Universiteti POLIS, disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore të Përgjithshme • Rregullore Programi (për çdo program)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 58




<p>diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore Diplomimi (për çdo program) <p>Çka bënte të mundur parashikimin e të gjitha procedurave në formë të detajuar, mënyrën se si studenti, ndjek programin por dhe e përfundon atë.</p> <p>IAL ka të miratuar rregulloren specifike të diplomimit ku janë të përcaktuara procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Rregullorja shpjegon të gjithë procesin e diplomimit të studentëve të cilët janë pjesë e IAL. FPMMU ka rregulloren e veçantë me të cilën përcaktohen procedurat e diplomimit, format dhe modalitetet e mbrojtjes etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.5 deri 10</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas ligjeve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, programi i studimit MSc duhet të përmbajë temë diplome. IAL në programin e studimit Msc i Integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban e përmbush këtë kërkesë ligjore duke organizuar diplomat MSc. Rregulloret e brendshme institucionale zbatohen në mënyrë korrekte dhe i ndihmojnë studentët si dhe pedagogët në procedura.</p> <p>Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. Udhëheqësi i punimit përgatit programin e punës së studentit, duke përcaktuar afatet për realizim.</p> <p>Departamenti miraton tezat e diplomës. Studentët informohen paraprakisht lidhur me procedurat për diplomën përmes mësimdhënësve të njësisë akademike – departamentit.</p> <p><i>Aneksi Nr.10</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Rregullorja e Diplomimit për Programin e Planifikimit dhe Menaxhimit Urban, parashikon në formë të detajuar se si funksionon Komisioni për Mbrojtjen e Diplomës.</p> <p>Hapat që studenti ndjek që nga përzgjedhja e temës deri në mënyrën e diplomimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.10</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Temat e diplomës janë gjithnjë në orijentim të kërkimeve, tematikave dhe interesave të departamentit apo njësisë së kërkimit. Studenti konsultohet paraprakisht mbi tematikën ku ka interes dhe kjo tematikë aprovohet me ndryshime apo pa ndryshime nga Dekanati. Ndërkohë për ti ardhur në ndihmë studentëve të cilët nuk kanë një drejtim të qartë mbi tematikën e diplomës, dekanati në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit dhe personelin e studios së diplomave, miratojnë një listë me tematika nga të cilat studentët mund të zgjedhin.</p>

	<p>Mësimdhënësit ndihmojnë studentët duke i orientuar në fushat e studimeve dhe duke ju siguruar informata paraprake dhe literature të nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Studenti konsultohet dhe ndihmohet nga udhëheqësi si dhe një konsulent.</p> <p><i>Aneksi Nr.10</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit, jo vetëm ndihmon studentet në vënien në dispozicion të plotë të laboratorëve, në liri të plotë për tu përdorur nën mbikëqyrjen e stafit akademik dhe personelit ndihmës, me qëllim përdorimin e tyre për grumbullim të dhënash për përdorimin e tyre në punimin/kërkimin shkencor.</p> <p>Në rastin kur natyra e temave të diplomave kanë nevojë për ekzaminime, institucioni i ndihmon studentët edhe jashtë IAL, për realizimin e tyre.</p> <p>Të gjitha mjediset e U_POLIS janë në shërbim të studentëve së bashku me administratën, personelin akademik dhe ndihmës.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, ndihmon në zgjedhjen e probleme si dhe asiston në analizë sintetike.</p> <p>Punimi përmban rezultatet dalëse, analiza të vlerave si dhe përfundime për të cilat udhëheqësi i punimit ka përgjegjësi dhe duhet të garantoj për vlera të pa cenueshme të punimeve.</p> <p>Punimi i diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i mbrojtjes së diplomave. Secili anëtarë vlerëson punimin në mënyrë të pa varur.</p> <p><i>Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.10</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë</p>	<p>Në përfundim të procesit të diplomimit studentin vlerësohet me notë, e cila bëhet pjesë dhe në listën e notave si dhe në suplementin e diplomës që studentin tërheq pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Vlerësimi komunikohet në prani të komisionit studentit nga kryetari i komisionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.14</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga QSHA.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave i integruar në "Planifikim dhe Menaxhim Urban" është një program i ciklit të dytë, me kohëzgjatje pesë vjet me kohë të plotë, me 300 ECTS në përfundim të të cilit lëshohet diploma me emërtimin: "Master Shkencor në Planifikim Dhe Menaxhim Urban".</p> <p>Diplomimi i studentit shoqërohet me diplomën ku shfaqet nr. i matrikullit të studentit, suplementi i diplomës ku ilustrohen lëndët, modulet në vite me</p>

	<p>përmbajtjen e tyre si dhe dëshmi për kreditet ECTS të cilat studenti ka akumuluar përgjatë studimeve të tij të cilat janë të transferueshme në vazhdimësinë e studimeve të tij.</p> <p>Pas përfundimit të diplomimit, studenti pajiset me diplomë dhe me suplementin e diplomës nga Ministria e arsimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.15.</i></p>								
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Krahas diplomës dhe suplementit të diplomës, studenti i diplomuar pajiset me një katalog të lëndëve të zhvilluara në vite më përshkrimin dhe peshën në kredite të çdo lënde i ofruar në dy gjuhët, shqip dhe anglisht.</p> <p><i>Aneksi Nr.5</i></p>								
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen</p>	<p>Një kopje të gjithë dokumentacionit që studenti tërheq kur diplomohej janë të arkivuara dhe në zyrën e Sekretarisë Mësimore, për një periudhe kohore të pacaktuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.10</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik,</p>	<p>Gjatë aktivitetit akreditues në U_POLIS, GVJ u interesua posaçërisht për të dhënat lidhur me personelin akademik PAE, PAK dhe me atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. Konsideruar si një faktor shumë të rëndësishëm për mbarrëvajtjen e gjithë aktivitetit të një institucioni, por veçanërisht procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor, GVJ konsultoi dokumentin e sjellë nga Institucioni lidhur me plotësimin e këtij kriteri si dhe protokollin e mbajtur gjatë vizitës në IAL dhe konkludon në plotësimin e këtij kriteri nga ana e institucionit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 61




<p>si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore na u vunë në dispozicion dosjet personale për secilin staf akademik të angazhuar, të cilat përmbanin CV-të, diplomatat dhe kualifikimet e stafit, kontratën e punës dhe deklaratën individuale të ngarkesës akademike dhe kerkimore, etj.</p> <p>Krahas kësaj dokumentacioni fizik, me sa u shpjegua secili antar i personelit akademik ka dhe profilin e tij në sistemin elektronik të menaxhimit të IAL-së.</p> <p><i>Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.11; RVB; Shënimet e vizitave U_POLIS.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>IAL ka të rregulluar dokumentacionin ligjor për personelin akademik, duke hartuar strategjinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke i formatizuar formatet e dosjeve personale të stafit të IAL.</p> <p>Për hartimin e RVB përveq tjerash ishin dokumentet, strategjitë dhe rregulloret për burimet njerëzore brenda IAL-së. Pjesë e këtyre procedurave ishte dhe rekrutimi që përmbante hapat të mirëpërcaktuara si shpallja e njoftimit për rekrutim të stafit akademik (me kritere që respektojnë legjilacionin në fuqi), seleksionimi, intervistimi, vlerësimi i kandidatëve gjatë intervistës dhe rekrutimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.11; RVB; Shënimet e vizitave U_POLIS.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kjo procedurë e sipërmundur bëhet transparente dhe publike për të gjithë të interesuarit nëpërmjet shpalljes së thirrjes për aplikime dhe kritereve të kërkuara në faqen zyrtare të institucionit: http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/367</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave U_POLIS; Shënimet e takimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Nga RVB, GVJ mësoi që nevojat për rekrutim personeli i paraqet Departamenti që mbulon programin e studimit. Nevojat mbështeten në shpërndarjen sa më racionale të ngarkesës mësimore të lëndëve të kurrikulës konkrete. Pra personeli i rekrutuar lidhet konkretisht me përballimin sa më të plotë të ngarkesës së lëndëve për të cilat ka edhe përvojën edhe njohuritë e duhura që garantojnë zhvillimin me cilësi të procesit mësimor dhe angazhim në punën kerkimore shkencore. Gjatë takimeve në institucion GVJ mësoi që personat e rekrutuar kanë përballuar me cilësi ngarkesën mësimore dhe kanë angazhim domethënës në kërkimin shkencor. Në takimin me studentët, ata shprehën vlerësime për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët e angazhuar në programin e studimit MSc PMU.</p> <p>Procedurat e sipërmendura bëhen transparente duke i publikuar për të gjithë të interesuarit nëpërmjet shpalljes së thirrjes për aplikime dhe kritereve të kërkuara në faqen zyrtare të institucionit: http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/367</p>

	<i>RVB; Shënimet e vizitave U_POLIS; Shënimet e takimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Gjithëpërfshirja është një aspekt shumë i rëndësishëm i trajtimit të personelit akademik, dhe siç shpjegohet në RVB dhe nga bisedat me njësitë e ndryshme dhe stafit gjatë vizitës në institucion, u vërejt një vëmendje e posaçme ndaj këtij aspekti si në kuptimin e ruajtjes së balancës gjinore ashtu dhe për personat me aftësi të kufizuara. Polis është dhe institucion koordinator i një projekti Erasmus me fokus pikërisht në garantimin e aksesit në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>Infrastruktura fizike është gjithashtu e përshtatshme për të garantuar një mjedis të përshtatshëm pune për të gjithë.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ vizitoi ambientet fizike si të strukturës administrative ashtu edhe të asaj mësimore e kërkimore-shkencore. Gjatë këtyre vizitave, bazuar edhe në të dhënat e RVB, GVJ gjeti që të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të aktivitetit universitar ishin me kushte të mira. Auditorët, klasat për seminarët e ushtrimet si dhe laboratorët kishin pajisjet e nevojshme për një aktivitet normal mësimor dhe një kërkim optimal shkencor. Hapësirat ishin të bollshme, me ndriçim të mirë me kondicionerë.</p> <p><i>Aneksi Nr.42.; Aneksi Nr.42.1 deri 42.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Krahas kualifikimit shkencor dhe rritjes profesionale, IAL ofron mundësinë për ngritje të kapaciteteve manaxheriale nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, kryesisht në kuadër të projekteve Erasmus të cilat përmbajnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve akademike, manaxheriale dhe administrative.</p> <p>GVJ u informua për metodat dhe procedurat që ndiqen në këtë institucion me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> <p>POLIS është pjesëmarrës dhe drejtues në shume projekte të tilla sidomos gjatë 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Aneksi Nr.33; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p>	<p>IAL një praktikë e tillë e ka filluar që me projektet Tempus, ku IAL ka qenë i angazhuar me 2 projekte DAPEEWB dhe CONSUS dhe më tej me projekte Erasmus+ si DRIVE, IDEA, VTECH, etj.</p> <p>Një pjesë e tyre kanë trajnime mbi pedagogjinë dhe metodologjinë bashkëkohore, një pjesë për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, etj.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve</p>	<p>Në këtë program studimi raporti PEA me PAK dhe sidomos raporti pedagog/student garanton një angazhim optimal të burimeve njerëzore për të ganatantuar arritjen e objektivave të programit dhe cilësinë e synuar të edukimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.11; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Në terma të infrastrukturës së nevojshme për realizimin e programit të studimit, POLIS disponon jo vetëm sipërfaqet e nevojshme në kuptimin e metrave katrore por dhe teknologji bashkëkohore për organizimin e mësimdhënies, praktikave dhe punëve laboratorike. Ambientet e vëna në dispozicion shfrytëzohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Auditorë mësimi - Studio - Ambiente për aktivitete promovuese - Laboratorë - Ambiente për kërkimin shkencor; - Ambiente shërbimi si (bibliotekë, salla interneti, fotokopjime, salla studimi, zyra për informim të studentëve si dhe ambiente ndihmëse të tilla si korridoret, ballkonet banjot) <p>Numri i studenteve në këtë program studimi nuk është shumë i lartë duke e bërë shumë komod organizimin e punës në grupe dhe detyrave të kursit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, i vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstaton që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 64




	<p>studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse.</p> <p><i>Aneksi Nr.42.; Aneksi Nr.42.1 deri 42.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studimi dhe punë të pavarur të studentëve.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve të cilat përdoren për studentët. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së miri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuara.</p> <p>Të gjitha sallat e mësimi janë të pajisura me kompjuterë dhe projektorë, kurse laboratorët (ato të kompjuterëve) por dhe laboratorët e tjerë janë të pajisur me teknologjitë e nevojshme hardware dhe software për edukimin e studenteve.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Pjesë e dokumentacionit të RVB ishte dhe një listë e plotë e ambienteve mësimore perfshi këtu dhe laboratorë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lab i Mjedisit - Lab i Eficences Energjitike (HVAC) - Dhe Lab i fundit i prototipizimit dhe fabrikimit dixhital <p>Të gjithë këto laboratorë përmbajnë pajise të avancuara të cilat mundësojnë aftësimin praktik të studenteve.</p> <p>Gjatë vizitës në U_POLIS GVJ vizitoi mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e Programit të studimit në MSc PMU të tilla si: auditorët, laboratorët, studiot, ambientet e shërbimit etj. dhe konstaton që ato janë të pajisura me mjete të tilla si kompjuterë, software profesionale, qasje në literaturë, mundësi shumëfishimi etj. të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>U_POLIS aktualisht ka 8 laboratorë me sipërfaqe dhe kapacitete të ndryshme, të gjithë të pajisur me kompjuterë dhe software të posaçëm për këtë program studimi si CAD, GIS, etj. në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit.</p>

<p>natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA • Laboratori i MAC • Laboratori i Qeramikës • Laboratori i Pikturës/Ilustrimit • Laboratori i Prototipizimit – i pasuruar me shume pajisje te reja. • Laboratori i Fotografisë • Laboratori i Eficiences Energjetike • Laboratori i ri kompjuterësh për lëndë – digital Architecture <p>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit Master i Shkencave i integruar në Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.42.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Krahas laboratorëve të vet, U_POLIS garanton realizimin e praktikave të ndryshme lëndore dhe profesionale në bashkëpunim me institucione të tjera që disponojnë pajisje specifike, si p.sh. laboratori ALTEA, instituti IGJEUM, etj.</p> <p>GVJ, mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion konstaton që IAL, kryesisht me kapacitetet që zotëron (laboratorë, studio) por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera (kryerjen e praktikave mësimore, internshipet) garanton mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.42.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UAL ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me personel ashtu edhe online. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj.</p> <p>Gjithashtu, të gjithë studentet e këtij programi kishin qasje të plotë në bibliotekën fizike por dhe ne dy e-Libraritë dixhitale të U_POLIS: EBSCO dhe JSTOR.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 66




	<i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.45.</i>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të U_POLIS.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm.</p> <p>IAL raporton një fond fizik prej më shume se 10.000 titujsh, i cili pasurohet vazhdimisht nga blerje të reja dhe donacione të ndryshme. Nga vizita në ambientet e bibliotekës rezultoi se për këtë program studimi ka një literature të pasur në dispozicion të studenteve me tekste shkollore ose dispensa të lëndëve të përgatitura nga pedagogët përkatës, literature e huaj dhe në gjuhën shqipe si dhe periodike shkencore.</p> <p>Drejtuesi i fakultetit por dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Buxhetit të Departamentit; ✓ Donacioneve nga partnere te ndryshëm; ✓ Kontribute te projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj ✓ Publikime/përkthime nga vete stafi i U_POLIS. <p><i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.45.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Të dy libraritë dixhitale: EBSCO dhe JSTor ofrojnë qasje pa pagese për të gjithë komunitetin e POLIS: studente dhe staf.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.45.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka inventarin e vet elektronik dhe në ambientet e saj ka një sërë kompjuterësh PC, ku studentet mund të kërkojnë në mënyrë të pavarur titujt që ju duhen përpara se ti drejtohen punonjësës së bibliotekës.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentët u njoftuan se në procesin mësimor shfrytëzohen software profesional sikur janë AutoCAD, Revit, 3D software etj.</p> <p>Studentët gjatë gjithë kohës së studimeve përdorin edhe <i>software</i>-at profesional për Planifikim dhe menaxhim Urban të cilat ndihmojnë në rritjen e shpejtësisë së punimit të Diplomës dhe cilësisë së sajë.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave. Aneksi Nr. 45.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të</p>	<p>Krahas blerjeve periodike (gjatë panairit të librit), promovimit të titujve të caktuar nga shtëpi botuese, dhe donacioneve të ndryshme, në fillim të çdo</p>

detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	semestri secili staf dhe departament mund ti drejtohet bibliotekës me kërkesën për blerje të titujve të rinj të nevojshëm si literaturë bazë ose literaturë e rekomanduar në kuadër të lëndëve të ndryshme mvsimore. <i>RVB; Shënimet e vizitave. Aneksi Nr. 45.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i bibliotekës përkon me orarin e zhvillimit të mësimin, si gjate javës ashtu dhe në fundjave për programet profesionale. Biblioteka funksionon çdo ditë të javës (nga e hëna në të diel), përveç festave zyrtare, dhe është në shërbim të studentëve nga ora 08:00-17:00 <i>RVB; Shënimet e vizitave. Aneksi Nr. 45.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	U_POLIS ka prej vitesh një sistem të menaxhimit elektronik të informacionit. Gjatë dy viteve të fundit sistemi i përdorur i platformës elektronike është Pitagora dhe studentet mund të i qasen nëpërmjet faqen elektronike të institucionit: https://polis.pitagora.rash.al/login Në këtë platformë elektronike studentet mund të qasen informatave lidhur me lëndët (syllabusin), orarin, mungesat, notat, njoftime të ndryshme në kohë reale nga sekretaria mësimore, etj. <i>Aneks Nr.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Pjesëmarrësit, të punësuarit e IAL, stafi akademik, administrativ etj. janë të informuar për strukturën e institucionit, ofertën akademike, cilësinë e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit etj. Ky informacion është i qasshëm nga studentët si tek faqja zyrtare e institucionit në <i>web</i> , në <i>face book</i> , në <i>YouTube</i> apo në <i>twitter</i> ashtu edhe pranë njësive strukturore të tilla si ZMSKK, NjSBC. Krahas stafit akademik dhe administratës edhe për studentët, sistemi mban të dhënat edhe për studentët (i cili gjithashtu logohet me kredencialet e tij personale). Në këtë portal stafi ka të dhënat e tij, përfshi kualifikimin

	<p>akademik dhe ka mundesi të shfaq syllabusin e lëndës, të vendosë vlerësimin e studenteve, të evidentojë mungesat e tyre, etj..</p> <p>Studentët informohen edhe me të dhënat e grumbulluara nga të diplomuarit lidhur me statistikat e punësimit, historitë e suksesit etj nëpërmjet broshurës ALUMNI.</p> <p><i>Aneks Nr.46; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Informacioni i qasshëm nga studentet dhe stafi është njëlloj vetëm për aspekte si rregulloret e institucionit, biblioteka dhe orari, kurse aspektet e tjera ndryshojnë. Edhe brenda personelit akademik varësisht pozicionit qe mban secili staf qasje në të dhëna dhe mundësia për të gjeneruar raporte është i ndryshëm.</p> <p>Institucioni ka siguruar për punonjësit akademikë dhe jo akademikë infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si printer, fotokopje, skaner, etj.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Krahas sistemit të menaxhimit, U_POLIS ka dhe qasje institucionale të autorizuar në platformën <i>Google Education</i>, që është përdorur masivisht gjatë pandemisë: <i>Google Classroom</i> dhe <i>Google Handouts</i> për ndërveprimin e drejtpërdrejtë mes stafit dhe studentëve.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi është programuar që të mund të gjenerojë raporte të ndryshme si për stafin drejtues, akademik ashtu dhe për administratën e IAL.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneksi Nr.11.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Website i Universiteti POLIS është një faqe zyrtare publike e IAL që përmban informacion të detajuar për të gjithë aktivitetin e institucionit si dhe të gjithë programet e studimit që ai ofron.</p> <p>Faqja është dygjuhëshe: shqip dhe anglisht.</p> <p>www.universitetipolis.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij. Këto raporte janë dhënë për të gjitha vitet akademike.</p> <p>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.</p> <p>Pjesë e strategjisë së zhvillimit të institucionit (5 vjeçarë – që përkon me kohëzgjatjen e një cikli të plotë studimi) është dhe strategjia financiare. Krahas kësaj në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, U_POLIS harton dhe një buxhet tre vjeçar dhe një buxhet një vjeçar që miratohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Ky buxhet vjetor është dhe pjesë e Raportit Vjetor që dorëzohet pranë MAS.</p> <p>Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tillë që të shërbejnë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.</p> <p><i>Aneksi Nr.49; Aneksi Nr.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Buxheti vjetor përmban një planifikim të detajuar financiar si të zërave të shpenzimeve (ku zëri paga për stafin akademik zë peshën më të madhe, shoqëruar me shpenzime materiale, operationale dhe në fund investime) ashtu dhe të burimeve të financimit.</p> <p>Diversifikimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet më rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të infrastrukturës lehtësuese siç mund të jenë laboratorët. Kjo, pavarësisht kostove të larta, institucioni ka treguar ndjeshmëri maksimale dhe është duke punuar për ngritjen e një laboratorit Testim Materialesh, gjë që do të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e studenteve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 70

	Tashmë në vitin e 15 të ofrimit, programi është tashmë i konsoliduar dhe parashikimi i buxhetit kryhet me saktësi shumë të lartë. <i>Aneksi Nr.49; Aneksi Nr.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i>			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhej rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve. Zyra e financës çdo vit hartonte bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani ndërkombëtare e specializuar (Mazars) konsulencë financiare e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare si dhe nëpërmjet një eksperti kontabël të autorizuar kontrollonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave. Ky dokument i bashkëngjitet Raportit Vjetor që IAL harton dhe dorëzon në MAS. <i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.48; RVB; Shënimet e vizitave.</i>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	POLIS raporton se ka një strategji, që prej 10 vjetësh tashmë por më e konsoliduar në 5 vjetet e fundit, për të rritur diversitetin dhe shumën e të ardhurave nga burime të tjera përtej tarifës së studimit. Të ardhurat dytësore në 5 vjetet e fundit kanë qenë në nivelin 10% të të ardhurave totale dhe synohet për të arritur në 20% të totalit. <i>Aneksi Nr.49; Aneksi Nr.4; RVB; Shënimet e vizitave.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Sipas RVB, POLIS synon të vazhdojë të punoj për diversifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit si një mënyrë për të minimizuar riskun e një luhajtje të mundshme në numrin e studenteve të regjistruar. Mbështetur në analizën e kostove si më sipër, U_POLIS bën bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky bilanc bëhet për çdo Program Studimi. Më tej, në funksion të nevojave dhe prioriteteve bëhet planifikimi i blerjeve dhe kryerja e tyre. GVJ u interesua lidhur me gjendjen financiare duke u referuar edhe tek asetet disponuese dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>Aneksi Nr.17; RVB; Shënimet e vizitave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 71

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konstaton që studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga U_POLIS për regjistrimin e tyre si dhe e kanë të plotë dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.</p> <p>Politikat, procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve, në Universitetin Polis, në programet e studimit që ofron, janë të përcaktuara në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatore, procedura të miratuara e të bëra publike.</p> <p>Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. www.universitetipolis.edu.al</p> <p>Në planifikimin e kuotave të pranimit për vit akademik, merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të U_POLIS. Pas miratimit të tyre në Senatin akademik të IAL-së, përcillen për certifikim nga MASR.</p> <p>I gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në faqen zyrtare të IAL-së dhe në rrjetet sociale të universitetit, veçanërisht kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi.</p> <p>Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë.</p> <p>Në U_POLIS vlerësohen herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimi i tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët</p>	<p>Studentët e Programit të Integruar të Studimeve Master i Shkencave i Integruara në “Planifikim dhe Menaxhim Urban, gëzojnë të drejta të barabarta, që nga momenti që bëhen studentë të POLIS e deri në diplomim. Nga biseda me studentë dhe ish studentë u vu re që ata orientohen</p>




<p>për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>vazhdimisht edhe nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), e cila i asiston dhe i ndjek studentët gjatë kohës së studimeve, ashtu edhe në përfundim të studimeve, dhe i këshillon për tregun e punës apo i ndërmjetëson në këtë proces, etj.</p> <p>Qëllimi i zyrës ZMSKK është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orientimi në tregun e punës • Krijimi i lidhjeve mes studentëve dhe punëmarrësve potencialë • Të shërbejë si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione • Të ofrojë shërbime trajnimi në bashkëpunim me kompani të ndryshme • Të rrisë numrin e të diplomuarve në profesionin e tyre • Të paraqesë nevojat për kërkime shkencore. <p>Informacioni i përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxënit, akreditimet e programeve etj jepet me anë të Guidës së Studentit. Në guidën studentore përfshihen edhe detaje të kurrikulës akademike, kritere dhe kushte që studentët duhet të plotësojnë psh për kalimin nga një vit në tjetrin, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.31; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhja e studentëve në programin Master të Integruar Planifikim dhe Menaxhim Urban janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Nga dokumentacioni i ofruar si dhe nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata i njihnin dhe njëkohësisht për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p> <p>Sipas RVB, pas akreditimit të programit të studimit MSc PMU, IAL ka implementuar ndryshime më mesataren e pranimit kriter ky i cili është i bazuar nga vendimet e MAS, duke rishikuar dhe rivlerësuar edhe testin e pranimit.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në programin e integruar të studimit Master i Shkencave në "Planifikim dhe Menaxhim Urban", janë të hartuara dhe publikuara çdo vit akademik të aksesueshme për të gjithë të interesuarit, në bashkëveprim me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p>GVJ konsultoi dokumentacionin lidhur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në këtë program të studimit dhe konstatoi që kriteri bazë është ai i notës mesatare.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 73




	<i>RVB; Shënimet e vizitave.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, përpara çdo viti akademik publiku dhe të interesuarit udhëzohen në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 31; RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Universiteti Polis harton dhe publikon përpara çdo viti akademik, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit, të programit të studimit, kuotat, mesatare minimale dhe kriteret të tjera në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 dhe Urdhrit të përvitshëm të MASR për pranimet e studentëve, si dhe vendimit përkatës të përvitshëm të Senatit Akademik.</p> <p><i>Aneksi Nr. 12; RVB; Shënimet e vizitave</i></p>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Pranimi kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 dhe Urdhrit të përvitshëm të MASR për pranimet e studentëve, si dhe vendimit përkatës të përvitshëm të Senatit Akademik të Universitetit POLIS.</p> <p>Lejohen që të ndjekin studimet në këto programe studimi ata kandidatë që:</p> <p>Kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave ose zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar jashtë vendit, të njehsuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.</p> <p>Janë fitues në konkurrimin midis kandidatëve aplikantë brenda kuotave të pranimit të paracaktuara çdo vit nga universiteti, të cilat shpallen në mjediset e dukshme dhe në faqen zyrtare të universitetit dhe në Portalin U-Albania në përputhje me Udhëzimin e MASR.</p> <p>Mesatarja minimale e përcaktuar nga MASR – kriter përjashtues; Mesatarja aritmetike – kriter renditës (me peshë specifike 30%); Test pranimi (me alternativa) – kriter renditës (me peshë specifike 70%) nga të dhënat mbi regjistrimin e studentëve , rregulloreve Institucionale - Fakulteti</p>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë	<p>IAL raporton se ofron bursa për kategori të ndryshme studentesh si bursat e ekselencës, ato për shtresat në nevojë, për fëmijët jetime, për fëmijët rome, bursa për fëmijët e policeve të rene në detyrë, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 45; RVB; Shënimet e vizitave, Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se U_POLIS ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e Universitetit POLIS, rregulloren e Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit. GVJ vlerëson se ky informimin behet ne forma alternative, fizikisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit Pitagora, nëpërmjet webit të universitetit. <i>Aneksi Nr.12; Aneks Nr.5; RVB; Shënimet e vizitave; www.universitetipolis.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ Referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore, rezulton se studentët në Universitetin POLIS kanë të drejtën të transferojnë studimet e tyre në degë të ngjashme edhe brenda U_POLIS, transferim qe realizohen vetëm në fillim të vitit. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në këtë informim të studentëve, por ky informacion sigurohet edhe nëpërmjet Webit të Universitetit, apo njoftimeve që dalin mbi datat e aplikimeve etj. <i>Ankesi Nr.31; RVB; Shënimet e vizitave; www.universitetipolis.edu.al</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se në fillim të çdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e kontrollit dhe skemën e vlerësimit në sezon si dhe detyrimet që kanë për studentët. <i>RVB; Shënimet e vizitave; www.universitetipolis.edu.al</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se U_Polis, ka në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit, kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës të cilat janë të publikuara në web. <i>Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr.31; RVB; Shënimet e vizitave; www.universitetipolis.edu.al</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të	Nga vizita në institucion, se U_POLIS planifikon dhe organizon aktivitete dhe takime informuese dhe “open days” informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, kryesisht maturantëve nga shkollat e mesme te qytetit si dhe të qyteteve të tjera në gjithë vendin në kuadër të procesit të pranimit në Programin e Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”.

ardhshëm mbi programin e studimit	<p>Përveç Zyrës së Pranimeve, është gjithmonë i pranishëm edhe një përfaqësues akademik nga program i ofruar nga U_POLIS.</p> <p>Ky proces përgjatë vitit akademik 2020-2021, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, u realizua online, përmes platformave të ndryshme dhe rrjeteve sociale.</p> <p><i>Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr.31;</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton që studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike mbi programet e studimeve dhe modulet përkatëse nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit si materialeve të botuara (broshura, fletëpalosje etj), materialeve elektronike të aksesueshme në faqen zyrtare të U_POLIS, sikur janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/49, - FB @Universiteti POLIS; https://www.facebook.com/polisuniversity/ - Instagram @polisuniversity https://www.instagram.com/polisuniversity/ <p>GVJ nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët e Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit në koordinim me sekretarinë mësimore informojnë studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ mësoi që ata informoheshin për rezultatet e fituara në lëndët e programit përgjatë dhe në përfundim të programit mësimor. Gjatë semestrit studentët vlerësoheshin në detyrat e parashikuara për të cilat merrnin edhe transparencën e kërkuar.</p> <p>Pas çdo provimi publikoheshin rezultatet paraprake për çdo student. Studentëve u lihej një afat për ankimimet e mundshme lidhur me rezultatet e provimit. Pedagogu i çdo lënde diskutonte me studentët për rezultatet e vlerësimeve. Nota përfundimtare vendosej mbas këtij procesi.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 76




	<i>Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr.31; Aneksi Nr. 27.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor. GVJ konstatoi se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti informon studentët për lëndën, syllabusin, temat literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lëndë</p> <p><i>Aneksi Nr.31; RVB; Takimet e organizuara; www.universitetipolis.edu.al</i></p> <p>https://www.ualbania.al/</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Nga vizita në zyrën e këshillimit të studentëve dhe asaj të karrierës rezulton se këto zyra zhvillojnë aktivitete për orientimin në tregun e punës, panaire, janë shumë aktive. Aktiviteti i kësaj zyre mbështetet në aktivitete të përshtatura me nevojat e studentëve sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se IAL u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Informacione dhe këshillime konkrete lidhur me tregun e punës dhe kontaktimin me punëdhënësit potencialë, studentët i marrin nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës e cila funksionon në institucion si njësi strukturore dhe e pavarur nga pikëpamja operative.</p> <p><i>Aneksi Nr.31; RVB.</i></p>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>GVJ gjatë vizitës dhe takimeve kuptoi që informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe kreditet është i aksesueshëm edhe në faqen web për të informuar edhe studentët jashtë institucionit Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><i>Aneksi Nr.31; RVB; www.universitetipolis.edu.al</i></p>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm PITAGORA disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Programin e Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”.</p> <p>https://polis.pitagora.rash.al/login;</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2635</p>
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	<p>Fakti që përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit PITAGORA, ruhet dhe arkivohet në formë të rregullt çdo arritje akademike e studentit krijohet lehtësi dhe favorizim sidomos në kushtet e zhvillimit të mësimdhënies online gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, dhe 2020-2021.</p>




	Pavarsisht distances studentët kishin mundësi që përmes sistemit të përditësoheshin. https://polis.pitagora.rash.al/login			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Për ruajtjen e dokumentacionit si në letër ashtu edhe medium elektronik, U_POLIS ka sektorin e Protokoll-arshivës, Dokumentet e arkivuara (materialet mësimore e ato të kërkimit shkencor si dhe i gjithë shkresimi administrativo-burokratik) ruhen në dosje të veçanta të ndara në vite.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me sekretarinë, konstaton se U_POLIS harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Këto të dhëna mbahen manualisht nga sekretaria edhe në mënyrë elektronike në sitemin e informacionit PITAGORA. Në hard copy në regjistrat e verifikuar ne sekretari ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistri Themeltar 2. Regjistri i Notave 3. Regjistri i Diplomave <p>https://polis.pitagora.rash.al/login</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Sekretaria dispononte statistika për studentët e regjistruar, të pezulluar dhe të larguar. Vendimet e largimit ishin pjesë e dosjes së studentit kurse në regjistrin themeltar ishte shënuar data e largimit ose diplomimit të studentit dhe referenca përkatëse. Të gjithë ishin të pajisur me numër matrikulimi. Po ashtu edhe tek dosja e studentit ishin të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara;</i></p>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga	<p>IAL nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit disponon të gjitha të dhënat për studentët, të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Të drejtën për të gjeneruar statistika vjetore për numrin e studentëve të</p>

<p>pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>regjistruar në PS, transferimet, largimet dhe të diplomuarit për çdo vit e kanë sekretaria mësimore dhe administratori i sistemit në U_POLIS.</p> <p>GVJ kishte në dispozicion nga IAL të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilat rezultojnë se janë pjesë e analizave periodike që departamenti bën apo raporteve vjetore në nivel institucioni. GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit etj. Rrjeti Alumni rezultoi se ishte krijuar prej shume vitesh në nivel institucioni dhe azhurnohej me të dhëna çdo vit.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara; Aneksi Nr.51.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban konstaton se U_POLIS lidhur me studentët e Programit të Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” ofron komoditetin e gjenerimit automatik të të gjitha statistikave të kërkuara nga MASR apo institucionet përkatëse, apo dhe nga vetë U_POLIS. Dhe mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në çdo lëndë, regjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të çdo lënde në hard copy dhe në soft copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar si dhe në sistemin elektronik të U_POLIS.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ referuar të dhënave vuri re që Universiteti disponon statistikatat mbi cilësinë në hyrje të studentëve (mesatarja në hyrje, shkollat nga vijnë, Dekanati si njësi kryesore që merret me studimin dhe kuptimin e këtyre rezultateve me qëllim orientimin e programit në formën e duhur për ti ofruar studentëve një program sa më efikas.</p> <p>Sekretaria mësimore bën raportet mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Shërbimit ndaj Studentit, informon lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit.</p> <p>Drejtorja e komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë, është njësi që analizon punësimin e studentëve të diplomuar sipas programeve të studimit, ofron shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, bën njoftime punësimi periodike, këshillim të personalizuar të karrierës si dhe jep ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.27; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Universiteti Polis parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Senati Studentor është i përfaqësuar nga student e të gjitha njësive akademike dhe nga ky grup kolegjal i studentëve delegohen qështjet me interes të IAL lidhur me studentët.</p> <p>Senati Studentor është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Nga biseda me përfaqësues nga kjo njësi u vu re angazhimi dhe aktivizimit i studentëve në aktivitete me veprimtari te ndryshme me qëllim promovimin dhe jetën aktive dhe sociale të studentëve.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Senati Studentor, është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike por dhe me ato jashtë akademike që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve. senati_studentor@universitetipolis.edu.al.</p> <p>Nga biseda me studentë përfaqësues të senatit, u vu re përfshirja e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje të caktuar, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Senatori i secilit vit zgjidhet me shumicë votash nga kolegjet e tij dhe mban kontakt të vazhduar me koordinatoren e programit, shefin e departamentit, etj lidhur me problematika të ndryshme që i shqetësojnë.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,</p>	<p>Universiteti Polis në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave jo burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke marrë në konsideratë edhe opinionin e studentëve të diplomuar në takime të posaçme çdo vit. Në këtë mënyrë vlerëson mendimin e studentëve të diplomuar për formimin që ata kanë marrë dhe sa kanë mundur të gjejnë veten në përputhje me tregun e punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

<p>duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga departamenti/fakulteti/NJSBC, si gjatë diskutimit të planeve mësimore në fazat e miratimit të tyre ashtu dhe në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës.</p> <p><i>Aneksi Nr.6; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Universiteti Polis garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, Kjo arrihet nëpërmjet takimeve të koordinatores së programit dhe përfaqësues nga Dekanati dhe student të programit të Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” me fokus ecurinë e semestrit; Vlerësimi i kushteve laboratorike: nevoja për përmirësime bazuar në pritshmëritë Universitet/Studentë.</p> <p>Për me tepër studentët përbëjnë 3/19 e Senatit akademik që është organi që miraton programet e studimit, si dhe të përfaqësuar në Njësinë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përgjegjëse për vlerësimin e tyre.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është një njësi që ndjek gjithë procedurat për garantimin e cilësisë në procesin mësimor. Kjo përfshin vlerësimin 360 gradë të stafit dhe organizatës, vlerësimin e studentëve, vlerësimin e vetvetes nga stafi, si dhe vlerësimin nga drejtuesit e Institucionit dhe njësiteve. Në bazë të gjetjeve, Njësia e Cilësisë dhe drejtuesit e institucionit marrin masat e duhura për përmirësim dhe/ose promovim kur është e nevojshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.6; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët e Programit të Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” mund të shprehin mendimin e tyre përmes plotësisht të pyetësorit nga sistemi për vlerësimin e pedagogut sipas mendimit të tyre. Kjo procedurë ndiqet dhe analizohet nga NJSBC. GVJ konstaton se studentët kanë të përcaktuar në rregullore, të drejtën e ankimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 81




Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.

Personeli akademik i U_POLIS është vazhdimisht i angazhuar në aktivitete shkencore në formën e shkëmbimeve dhe konferencave.

a) U_POLIS; që prej vitit 2012, i japin mundësi stafit çdo fillim viti akademik:

- ✓ të marrin pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të realizuar në kuadrin e këtyre aktiviteteve, me një netëork të gjerë nga Rajoni, Mesdheu, Europa Perëndimore, Amerika etj. me artikuj që publikohen në një Proceeding të kontrolluar nga një komitet shkencor ndërkombëtar dhe që kalon proceset peer-review.
- ✓ të organizojnë dhe udhëheqin workshop-e me studentët, në përputhje me kërkimet e tyre akademike personale ose institucionale, duke kontribuar në avancimin ose përmirësimin e tyre.

GVJ konstaton që edhe personeli akademik i angazhuar me programin e studimit MSc PMU merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. Ky aktivitet pasqyrohet në analizën vjetore të fakultetit që bëhet periodikisht çdo vit. Në këtë analizë referohen arritjet në aktivitetin shkencor e botues dhe përcaktohen politikat e kërkimit shkencor.

Aneksi Nr.17; RVB; Takimet e organizuara.

Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.

Kërkimi shkencor është pjesë integrale dhe e domosdoshme e arsimit të lartë, ka qenë pjesë e veprimtarisë institucionale të Universitetit POLIS që në gjenezën e tij.

Universiteti POLIS, ka krijuar një rrjet me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me:

Shkollat Europiane të Arkitekturës (EAAE), Planifikimit (AESOP), Peizazhit (ECLAS), Menaxhimit (CEEMAN), Ndërtimit (EUCEET)

Anëtarësime si: Organizata CEEPUS, Magna Charta Universitarum etj.

Marrëveshje bashkëpunimi me institucione, universitete shqiptare dhe të huaja, organizata profesionale si dhe biznese të ndryshme

Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34; Aneksi Nr.35; RVB; Takimet e organizuara.

Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.

Referuar RVB pohohet që studentët inkurajohen të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji inovative të cilat u krijojnë atyre mundësi të përfshihen në kërkimin shkencor. Fokusi i punës i IAL, Fakultetit/ departamentit ka qenë angazhimi i studentëve në programe shkëmbimi dhe mobiliteti.

	<p>Stafi Akademik i Programit Master Shkencor i Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” nën drejtimin e Fakultetit, çdo fillim viti akademik, parashikojnë mënyrat se si studentët mund të përfshihen dhe inkurajohen në studime dhe projekte të ndryshme, të njihen me strukturën dhe metodat e kërkimit shkencor duke krijuar në këtë mënyrë hapësirën e nevojshme për të zhvilluar kërkimin shkencor në grup dhe në formë individuale duke përfshirë si pjesën teorike ashtu edhe kërkimin aplikativ.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Stafi Akademik kanë mundësi të botojnë në Revistën Shkencore Forum A+P, dhe në botime të tjera të POLIS Press: Habitat, MAD Magazine www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/49 apo botimet ndërkombëtare në strukturën Observatori i Basenit të Mesdheut OMB www.ombresearchseries.org/ si rezultat i kërkimit gjatë një viti akademik në kuadër të programit ndërkombëtar doktoral në arkitekturë dhe planifikim urban, apo i kërkimeve të tjera më të gjera ku institucioni merr pjesë.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët ata thanë që personeli akademik i motivon dhe mbështet studentët të angazhohen me studime sidomos në kuadrin e realizimit të temave të diplomave.</p> <p>Në saje të marrëveshjeve/bashkëpunimeve dhe përfshirjeje kanë krijuar hapësirën dhe kontekstin e duhur që studentët të përfshihen në projekte konkrete inovatore në proces.</p> <p><i>Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34; Aneksi Nr.35; RVB.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>GVJ konstatoi që stafi akademik ishte përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët që kanë në udhëheqje duke vlerësuar si performancën ashtu dhe progresin e tyre.</p> <p>Një pjesë e studentëve, mbi bazën e zgjedhjes, angazhohen ose zhvillojnë internshpin pranë njësisive të pavarura si OMB (Observatori i Pellgut të Mesdheut - www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1973 ose Co-Plan (Instituti për Zhvillimin e Habitatit - www.co-plan.org</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.7

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 83

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit	<p>Referuar RVB gjendet që FPMMU ka realizuar kryesisht bashkëpunime me njësitë kryesore ta U_POLIS si dhe me IAL partnere. Këto bashkëpunime kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të programit të studimit.</p> <p>Studentët e çdo cikli, ku studentët e Masterit Shkencor të Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, prej vitit 2015 janë përfshirë në një masë të konsiderueshme, si rrjedhojë e marrëveshjeve të mobiliteteve, në kuadër të Programit Erasmus + KA107 (Credit mobility), kanë përfituar nga mundësitë e vazhdueshme për shkëmbime, me përjashtim të vitit të shkuar ku si pasojë e pandemisë, mundësitë për mobilitet kanë qenë të reduktuara.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	<p>Gjatë kurrikulës akademike në programin Master Shkencor i Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, studentët bëhen pjesë e kurseve si “Metoda Kërkimore” dhe “Studio Diploma” në format studio, i sigurojnë studentëve instrumentet e nevojshme të kërkimit, për mbylljen me sukses të ciklit 5 vjeçar të studimeve dhe siguron një përgatitje të përshtatshme e cilësore për kërkim në ciklin e tretë.</p> <p>www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</p>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.	<p>GVJ vlerëson që konceptimi dhe ndërtimi i kurrikulës të programit të studimit MSc në Planifikim dhe Menaxhim Urban është projektuar me ambicien për të përgatitur studentët me kompetenca të tilla që ata të përfshihen në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p> <p>Universiteti POLIS përveç projekteve të fituara nga programet Erasmus+, Horizon 2020, etj. ka konfirmuar me sukses kapacitet e veta, duke arritur të fitojë edhe shtatë projekte të tjera të ofruara nga BE, të cilat shikohen jo vetëm si një arritje, por dhe një përgjegjësi institucionale.</p> <p>Përfshirja e studentëve të Programit Master Shkencor i Integruar në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” përmes shkollave verore apo workshopeve të përbashkëta, me shkolla partnere ndërkombëtare.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	<p>Me politikën e realizimit të marrëveshjeve me institucione partnere të huaj, IAL kërkon integrimin e kërkuesve të huaj në punën e vet kërkimore shkencore</p> <p>U_POLIS ofron programe akademike të përbashkëta dhe projekte kërkimore të përbashkëta, në partnerë ad hoc të përzgjedhur për veprimtari të caktuara</p>



	si workshop-et e përbashkëta, veprimtaritë kërkimore të përbashkëta dhe skema për mobilizim të personelit akademik. <i>Aneksi Nr. 32; Aneksi Nr. 3; RVB; Takimet e organizuara.</i>								
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Angazhimi i studentëve në veprimtari të ndryshme kërkimore ndërkombëtare mbështetet nga një sërë aktivitete që kanë në bazë një numër laboratorësh ndërkombëtarë dhe strukturash kërkimore që sigurojnë infrastrukturën e përshtatshme për kryerjen e kërkimeve cilësore. <i>Aneksi Nr. 3; RVB.</i>								
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Institucioni ka ndërtuar marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me personel akademik të huaj apo dhe aktivizimin e studentëve të huaj për periudha të ndryshme kohore për të plotësuar gamën e njohurive profesionale nga ana e studentit. <i>Aneksi Nr. 3; RVB</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ, referuar RVB, mëson që IAL ka të ngritur një sistem funksional informacioni për të përcjellë tek studentët gjithë çfarë atyre u nevojitet në lidhje me programin e studimit MSc PMU: procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, rregulloren e provimeve, procedurat që lidhen me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. GVJ konstaton se U_POLIS nëpërmjet njësisive të posaçme në strukturën organizative zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e U_POLIS. Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NjsBC, Zyrës e mbështetjes së studentëve, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, etj.. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve www.universitetipolis.edu.al
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për	U_POLIS ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 85

informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni siç është, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës informon studentët me transparencë të plotë për çështjet dhe aspektet akademike, mësimore, si edhe me të drejtat dhe detyrat e tyre.</p> <p>Ajo orienton studentët drejt zgjedhjes së fushave specifike formuese sipas profilit të tyre dhe i njeh ata me mundësitë që universiteti ofron. Gjithashtu, informon studentët lidhur me tregun e punës dhe mundësi që ai ofron, duke luajtur rolin e ndërmjetësit në këtë mes.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ka bërë një studim më të hollësishëm mbi nivelin e punësimit, natyrën dhe përputhshmërinë e punësimit me formimin e përgjithshëm dhe specifik të çdo studenti, duke i ndjekur e mbajtur kontakte me ta edhe pas diplomimit.</p> <p>Orientojnë studentët për një përputhshmëri më të mirë me tregun që është gjithmonë në evoluim.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 86

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 103 përcaktohet “<i>Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për SBC. Struktura dhe funksionimi i NjSBC përcaktohen në statutin e IAL</i>”. Në zbatim të këtij ligji, GVJ konstaton që IAL e ka funksionuese NjSBC.</p> <p>IAL i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm dhe ka fituar akreditimin institucional në vitin 2009 përmes Urdhrit Nr. 227 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për Akreditimin Institucional dhe të Programeve të Studimit të Shollës së Lartë Universitare “Universiteti POLIS”. Ky vendim përfshin gjithashtu akreditimin e programit të Ciklit të Dytë në Planifikim & Menaxhim Urban. Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.</p> <p>IAL ka ngritur dhe stabilizuar prej vitesh sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe procedural.</p> <p>Sigurimi i cilësisë në programin Master i Shkencave “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, ashtu si dhe në programet e tjera që ofron institucioni realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJBSC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të stafit akademik si dhe bashkëpunimi me struktura e fakultetit.</p> <p>Të gjitha politikat për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Dekanati dhe Senati Akademik.</p> <p><i>Ligji për arsimin e lartë;RVB; Takimet e organizuara.; Aneksi Nr.8.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit.</p> <p>NJSBC në Universitetin POLIS përbehet nga 9 anëtarë nga të cilët një student i diplomuar (Alumnus i POLIS) dhe i përfaqësues nga komuniteti i biznesit, institucion partner i POLIS ne cilësinë e ekspertit te jashtëm qe sjell perspektiven e tregut se bashku me studentin e diplomuar.</p>




	<p>Ndërgjegjësimi i personelit të U_POLIS mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627</p> <p><i>Aneksi 41.1; Aneksi 41.2; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Akreditimi i parë institucional dhe programor është kryer në Universitetin POLIS ne 2009. Që atëherë institucioni i është nënshtruar konkretisht proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, kryesisht nëpërmjet akredimeve (ky është akreditimi i tretë i këtij programi), por dhe vlerësimit të cilësisë nga organizma ndërkombëtare. Ky program studimi është vlerësuar nga AESOP në 2014 ne kuadër te procesit te Quality Assessment te zhvilluar nga ata posaçërisht për programe ne disiplinën e planifikimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.37; Aneksi 40; Aneksi Nr. 40; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në këtë institucion është ngritur që në fillimet e tij. Në vitet 2006-2007 ky funksion është kryer nga grupet ad-hoc të ngritura me urdhër të Rektorit. Në vitet 2007-2008, me vendim te rektorit u ngrit grupi i posaçëm për këtë qëllim. Detyra e kryer ishte monitorimi i orëve mësimore të zhvilluara, menaxhimi i vlerësimit të procesit mësimor nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga studentet në fund të çdo semestri akademik. Institucionalizimi i këtij sistemi u realizua nëpërmjet ngritjes së grupit të përhershëm të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, në Maj 2008.</p> <p>Pas këtij procesin kjo njësi funksionon vazhdimisht në përmbushje të detyrave të përcaktuar me paraqitjen e raporteve përkatëse vjetore dhe përcjelljes së tyre në strukturat përkatëse akademike si të përcaktuar në rregullore.</p> <p>I gjithë stafi i nënshtrohet vlerësimit nga studentet, koleget, eproret, vlerësimit te kërkimit, kryen vetëvlerësimin dhe angazhohet për të vlerësuar koleget (peer evaluation), kjo shërben për shpërhapjen dhe forcimin e kulturës së cilësisë në të gjithë institucionin.</p> <p><i>Aneksi Nr.37; Aneksi 40; Aneksi Nr. 40; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.2




Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë qellim është NJSBC, ajo drejton procesin e marrjes se feedback nga studentet, stafi dhe ekspertet e jashtëm qe janë anëtarë te vete njësisë dhe bazuar mbi këtë input harton një raport me rekomandime për përmirësime te mundshme, qofshin këto ne përmbajtje, ne metodologji, ne staf, etj.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në universitet.</p> <p>Qëllimet e NJBSC janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dhënien e informacionit sa më të qartë dhe këshillave të dobishme për sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e tij nga komuniteti POLIS; • Zhvillimin e politikave dhe procedurave efikase duke bashkëpunuar me stafin akademik për rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies; • Zhvillimi i një sistemi cilësie për veprim të ndërgjegjshëm, të përputhshëm dhe vazhdimisht të programuar për të përmirësuar performancën akademike dhe administrative; • Rritjen e angazhimit në proceset e sigurimit të cilësisë në të gjithë universitetin, përmes ofrimit të një sërë seminareve trajnuese. <p>Ky raport diskutohet fillimisht ne departament dhe fakultet dhe nëse është e nevojshme te bëhen ndërhyrje ne program ato diskutohen dhe miratohen ne Senatën Akademik.</p> <p>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627</p> <p><i>Aneksi Nr.37; RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>I gjithë procesi i vlerësimit të mësimdhënies dokumentohet në raportin e NJSBC. Procese të tjera si feedback nga Alumni (nëpërmjet një pyetëtori te posaçëm), ose minutat e takimeve të departamentit ku diskutohen përmirësime eventuale të programit janë gjithashtu të formalizuara dhe dokumentuara.</p> <p><i>Aneksi Nr.37; RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe</p>	<p>Metodologjia e vlerësimit të programit të studimit konsiston në vlerësimin e secilës lëndë/modulit si dhe secilit staf të angazhuar në 360 grade: vlerësimi nga studentet, vlerësimi nga kolegët dhe vetëvlerësimi.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafë», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 89

mbarëvajtjen e programit të studimit.	Këto të dhëna më pas shqyrtohen në nivel departamenti dhe fakulteti për të prodhuar të dhëna makro në nivel institucional. <i>RVB Aneksi Nr. 7.</i>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet dokumentohen në sistemin e menaxhimit elektronik të të dhënave në POLIS (ku dhe kryet ky vlerësim), në raportin semestral dhe atë vjetor të hartuar nga NJSBC. Raporti final i NJSBC prezantohet në mbledhje të hapur të Senatit Akademik dhe i dorëzohet dhe MASR si pjesë e Raportit Vjetor. <i>Aneksi Nr.37; Aneksi Nr. 40.1; RVB.</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raporti i NJSBC është i strukturuar të përmbajë të dhënat numerike por dhe interpretimin e tyre dhe rekomandimet që rezultojnë nga interpretimi i të dhënave të vlerësimit. <i>Aneksi Nr.37; Aneksi Nr. 17; RVB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i programit kryhet në bazë semestrale, me vlerësimin final në fund të vitit akademik. Ky informacion përfshihet në raportin e përvitshëm vjetor si dhe shërben si reference për hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm në kuadër të procesit të akreditimit. Programet Master i Shkencave vlerësohen pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJSBC në bashkëpunim me koordinatoren e procesit mësimor. Procesi vlerësimit deri më sot mbështetet në vlerësimin nga studentët, nga kolegët, nga eporët dhe vetëvlerësimi. Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik me pjesëmarrje të lirë të stafit. Si përgjigje, <i>feedback</i> ndaj mangësive, problemeve apo sugjerimeve, drejtuesit kanë marrë masa konkrete që lidhen me procesin mësimor, strukturën didaktike apo cilësinë e korrektësinë e mësimdhënësve të veçantë.

	<i>Aneksi Nr.37; Aneksi Nr. 17; RVB.</i>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	<p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit konsiston në konsultimin e burimeve të ndryshme (student, staf, drejtues dhe vete-vlerësimi). Për secilin prej tyre ka formularë të posaçëm nëpërmjet të cilëve bëhet mbledhja e të dhënave.</p> <p>POLIS organizon pyetësor të brendshëm mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, dhe cilësinë e mësimdhënies dhe po planifikon ta publikojë në të dhënat kryesore në faqen e internetit të U_POLIS</p> <p><i>Aneksi Nr.37; RVB; Takimet e organizuara</i></p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor metoda të shumëllojshme, të drejta dhe të tërthorta.</p> <p>Këtu përfshihen sondazhet e studenteve aktual dhe alumni, interesimet me shkrim dhe në auditorë drejtpërdrejtë, ndjekja e ecurisë së studenteve, pjesëmarrje në mbrojtjen e diplomave, punësimi i tyre, opinionet mbi kurrikulen, mësimdhënien, rezultatet e të nxënësve dhe orientimi i tyre në tregun e punës, etj.</p> <p>Në raste të veçanta bëhen sondazhe të posaçme për të tërhequr mendimin e studenteve, një shembull i përmendur gjatë vizitës ishte një sondazh i kryer gjatë pandemisë për cilësinë e organizimit të mësimi online si dhe ofrimin e shërbimeve të tjera ndaj studentit në kushtet kur administrata punonte nga shtëpia.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.7.</i></p>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e	<p>Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.</p> <p>Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit. Kjo tregon që institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit MSc në PMU, në kuadër të SBC-së.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.8</i></p>

dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Përsa i përket vlerësimit të cilësisë, krahas kontrollit nga ana e strukturave drejtuese, NJSBC përfshin në këtë proces stafin akademik dhe ndihmës të institucionit, studentet, një përfaqësues ALUMNI dhe një përfaqësues nga një institucion partner i POLIS si ekspert i jashtëm. <i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.8</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	IALmbështetur në aktet ligjore dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NJSBC në përbërje të së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruar nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB. Gjatë takimit me NJSBC u kuptua që anëtarë të ndryshëm të njësive ishin përgjegjës për komponentë të ndryshëm të vlerësimit (disa për mësimdhënien, disa për kërkimin, disa për administratën), kurse roli i Alumni dhe përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit është sjellja e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

e-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

faqe 92

	informacionit për zhvillimet e tregut dhe validimi I rekomandimeve për përmirësimin e programit. <i>Aneksi Nr.37; RVB; Takimet e organizuara</i>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në shqyrtimin e gjithë materialeve të RVB si dhe në takimet gjatë vizitës në IAL, GVJ gjenë që në sigurimin e cilësisë në programin e studimit MSc PMU është garantuar dhe është realizuar përfshirja e njësisë bazë, Departamentit dhe kryesore FPMMU, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. Parë që komponentët e vlerësimit të mësimdhënies përfshijnë krahas vlerësimit të studenteve dhe vlerësimin nga koleget dhe nga eproret, përfshirja e njësisë baze dhe asaj kryesore garantohet. <i>RVB; Takimet e organizuara</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe të sigurohet objektiviteti si nga ana e stafit ashtu dhe nga ana e studenteve, studentet e bëjnë vlerësimin për pedagogët në fund të lëndës (pa filluar sezoni i provimeve). Ky vlerësim pedagogëve iu behet i ditur vetëm pasi ata kanë kryer vendosjen notave të studenteve. Në këtë mënyrë sigurohet që vlerësimi të jete i pa influencuar. Këto cilësi të të dhënave u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. Kjo dëshmon që përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit ka respektuar integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.8, Aneksi Nr.30</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Konkretisht për këtë program studimi, krahas ekspertit të jashtëm anëtar i NJSBC, një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit jep rrejtja e partnereve të Shoqatës së Shkollave Europiane të Planifikimit – AESOP, ku POLIS është anëtar aktiv dhe ka qenë subjekt vlerësimi për cilësinë e programit. Po ashtu nga vizita në institucion, GVJ mësoi që janë konsultuar edhe ekspertë të tjerë nga tregu i punës dhe nga partnerët bashkëpunues. Mendimet dhe sugjerimet janë konsideruar jo vetëm duke u përfshirë në RVB por edhe duke u realizuar konkretisht. <i>RVB; Ankesi Nr. 8</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte me gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon. Këto raporte, krahas shpërndarjes me e-mail, prezantohen në mbledhje të Senatit Akademik, ku janë prezent i gjithë stafi dhe përfaqësia studentore, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësues të zyrave të NJSBC u njoh me veprimtarinë konkrete të kësaj zyre dhe konstaton që aktiviteti konkret i tyre synon dhe realizon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC përpunon të dhënat e marra nga formularët e vlerësimit dhe harton një raport të përmbledhur numerik të cilin e dorëzon në Rektorat. Në rast problematikash specifike kur kërkohet një informacion më i detajuar, informacioni që jepet ruan anonimitetin.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues të zyrave të NJSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ u informua për të gjitha procedurat që ndiqen nga këto zyra për sigurimin e cilësisë, duke filluar me rishikimin e planeve mësimore, vlerësimin e mësimdhënies nga pedagogët nëpërmjet vizitave në klasa dhe intervistimit të tyre mbi cilësinë e programeve, angazhimin e studentëve nëpërmjet sondazheve mbi zhvillimin e provimeve etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.37; RVB; Takimet e organizuara</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në rezultatet e procesit të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport me rekomandime për përmirësime të mundshme në staf, në procesin e mësimdhënies, kurrikules, metodologjisë, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.37; RVB; Takimet e organizuara</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Njësia e cilësisë i nënshtrohet dhe vetë një procesi vlerësimi. Studentët krahas mësimdhënies vlerësojnë dhe performancën e njësive të ndryshme administrative dhe mbështetëse në POLIS si Zyra e Mbështetjes së Karrierës, Sekretaria Mësimore, IT, etj. Pjesë e këtij vlerësimi është dhe NJSBC si një mënyrë për të matur efektivitetin dhe impaktin e aktivitetit të saj.</p> <p><i>Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.37; RVB</i></p>




Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Krahas përfshirjes se tyre aktive ne procesin e sigurimit te cilësisë, NJSBC zhvillon një sere seminaresh trajnuese për staf dhe studente. Një pjese e stafit trajnohet gjithashtu nga projekte te ndryshme Erasmus për aspekte te veçanta te cilësisë se mësimdhënies e mësim nxënies. <i>Aneksi Nr.17; RVB</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	---------------------------------------




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Integruar “Planifikim dhe Menaxhim Urban” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Polis”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Program i hapur para 15 vjetësh që ka kaluar shumë procese vlerësimi dhe ka dëshmuar qëndrueshmëri ne treg.
2. Kurrikula si përmbajtje dhe metodologji garanton arritjen e objektivave të programit të studimit dhe aftëson studentet me njohuri teorike e teknike, si dhe kompetenca praktike që i përgatisin ata për nevojat e tregut.
3. Përfshirje e lartë e studenteve në projekte konkrete si plane zhvillimi (Shkodra, Dropulli), projekti 100 fshatrat, etj.,
4. Kapacitete të përshtatshme akademike për ofrimin e programit, stafi akademik është i mirë kualifikuar dhe raporti pedagog / student është optimal.
5. Infrastruktura shumë e mirë në funksion të mësimdhënies: laboratorë të mirë-pajisur dhe biblioteka fizike dhe dixhitale.
6. Numër i larte partneritetesh me institucione homologe dhe me aktorë nga tregu që mundësojnë organizimin e praktikave mësimore e profesionale.
7. Shkallë e lartë e ndërkombëtarizimit të programit (në nivel stafi, rrjetëzimi me shkollat simotra europiane (AESOP, ISOCARP, ENHR) si dhe një sërë projektesh Erasmus që garantojnë mobilitet të lartë të stafit dhe studenteve.
8. Shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve që provon perputhshmërinë e lartë të programit me tregun e punës.

Pika të dobëta

1. Megjithëqë rëndësinë dhe ndërgjegjësimin ne rritje për një zhvillim me te qëndrueshëm dhe për eksperte qe hartojnë politika dhe plane për një menaxhim me te mire te territorit, ky profesion ne Shqipëri ka akoma nevojë qe te njihet dhe kuptohet me shume. Kjo reflektohet ne një numër studentesh i cili ndonëse ne rritje ka potencialin te jete shume me i larte, ne rast se planifikimi urban do te kishte ne Shqipëri te njëjtin reputacion dhe prestigj qe ka ne vendet e zhvilluara.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon të shtohen përpjekjet institucionale për njohjen dhe ndërgjegjësimin e publikut rreth këtij profesioni, duke bërë të mundur edhe shtimin e numrit të studentëve që ndjekin këtë fushë.



Evaluation conclusions regarding the second cycle study program Integrated Master "Urban Planning and Management" offered by the Higher Education Institution "Polis University"

Strengths and affirmations

1. Program opened 15 years ago that has gone through many evaluation processes and has proven stability in the market.
2. Curriculum as content and methodology guarantees the achievement of the objectives of the study program and enables students with theoretical and technical knowledge, as well as practical competencies that prepare them for market needs.
3. High involvement of students in concrete projects such as development plans (Shkodra, Dropulli), the project 100 villages, etc.,
4. Adequate academic capacity to provide the program, the academic staff is well qualified and the lecturer / student ratio is optimal.
5. Very good teaching infrastructure: well-equipped laboratories and physical and digital libraries.
6. High number of partnerships with counterpart institutions and market actors that enable the organization of teaching and professional practices.
7. High degree of internationalization of the program (at staff level, networking with European sister schools (AESOP, ISOCARP, ENHR) as well as a series of Erasmus projects that guarantee high mobility of staff and students.
8. High degree of employment of graduates that proves the high compatibility of the program with the labor market.

Weaknesses

1. Despite the growing importance and awareness for a more sustainable development and for experts who draft policies and plans for a better management of the territory, this profession in Albania still needs to be known and understood more. This is reflected in a number of students who, although increasing, have the potential to be much higher, if urban planning would have in Albania the same reputation and prestige that it has in developed countries.

Recomandations

1. EEG recommends to increase institutions effort for public awareness regarding the profession, making it possible to increase the number of students who attend this profile.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

